



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



# **RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2017**

**01 janar 2017 - 31 dhjetor 2017**

**Mars 2018  
Prishtinë**

## **P Ë R M B A J T J A**

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Korniza Ligjore
3. Përshkrimi i Institucionit (Organizmi institucional)
4. Fushëveprimi që e mbulon institucioni
5. Aktiviteti për periudhën raportuese
6. Pjesa e fundit e raportit - rekomandimet/sfidat e institucionit (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)
7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm
8. Raporti financiar

## **1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Duke u bazuar në Nenin 87.2.13 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji dhe të legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Marsit të vitit vijues kalendarik.

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2017.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 87.2.12 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike.

Është ky viti i trembëdhjetë me radhë që KRPP-ja përgatitë një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2017. Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit.

## **2. KORNIZA LIGJORE**

### **2.1 Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë**

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.

Me qëllim të funksionimit të mirë, KRPP ka nxjerrë Rregulloren e Punës, si dhe ka nxjerrë Udhëzime Operative për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, i cili ofron një sërë udhëzime operative praktike për menaxhmentin dhe stafin e KRPP-së. Udhëzimet Operative ofrojnë një prezantim të strukturuar dhe të kuptueshëm të KRPP-së në përgjithësi, roleve, përgjegjësi dhe kompetencave, si dhe udhëzime specifike për implementimin e funksioneve të KRPP-së që i janë dhënë me këtë ligj. Udhëzimet janë përgatitur në mënyrë që të lehtësojnë prezantimin e Rregullave Procedurale si dhe të udhëzojnë menaxhmentin dhe stafin e KRPP-së përgjatë procedurave të ndryshme shqyrtuese dhe administrative të cilat janë pjesë e operacioneve të përditshme.

Që të dy aktet e brendshme të KRPP-së: Rregullorja e punës, si dhe Udhëzimet Operative për Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik janë të publikuara në ueb-faqen e KRPP-së: <http://krpp.rks-gov.net/>

## **3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT (ORGANIZIMI INSTITUCIONAL)**

### **3.1 Misioni/Vizioni**

Misioni i KRPP-së është zhvillimi funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrejedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënie, konkurrencën e ndershme, trajtim të drejtë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin të kornizës ligjore të prokurimit publik;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi;
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit publik;
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë akterëve të prokurimit publik;
- Prezantimin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbëra dhe të përgjegjshme shoqërore të prokurimit publik;
- Shfrytëzimin e metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar; si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

### **3.2 Funksionet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik sipas ligjit**

Funksionet kryesore të KRPP-së janë të detajuara në Nenin 87 të Ligjit dhe mund të përmbliidhen si më poshtë:

- **FUNKSIONI LIGJOR;**
- **FUNKSIONI I MONITORIMIT;**
- **FUNKSIONI I TRAJNIMIT; dhe**
- **FUNKSIONI I REVOKIMIT TË CERTIFIKATAVE TË PROKURIMIT.**

#### **Funksioni Ligjorë**

Divizioni i Rregullave të KRPP-së është përgjegjëse për vendosjen e rregullave dhe kushteve që rregullojnë implementimin e çdo llojit të aktiviteteve të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, përfshirë kontratat kornizë. Për më shumë, KRPP duhet të nxjerrë rregullat që detajojnë menaxhimin e kontratave. Të nxjerrë rregulla për autoritetet kontraktuese në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngjarje iniciuese për intervenime të KRPP-së në Legjislacionin sekondarë të Prokurimit Publik do të jenë zbrazëtira dhe mangësi që përsëriten të detektuara dhe dokumentuara gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik.

#### **Funksioni i monitorimit**

Divizioni i monitorimit kryen monitorimin e planifikuar, monitorimin sipas rastit (ad-hoc) të prokurimit dhe monitorimin e Njoftimeve.

## **Funksioni i Trajnimeve**

Divizioni i Trajnimeve të KRPP-së është përgjegjëse për hartimin dhe zhvillimin e moduleve trajnuese dhe kurrikulës për kualifikimin e zyrtarëve të prokurimit. Në këtë aspekt Divizioni i Trajnimeve do të shfrytëzojë zbrazëtitrat dhe mangësitë e detektuara dhe dokumentet gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik. Divizioni i Trajnimeve është gjithashtu përgjegjëse për të identifikuar trajner të përshtatshëm (trajner individë apo organizata të trajnimeve) në prokurimin publik për të ofruar kurset relevante. Divizioni, në bashkëpunim me IKAP-in, duhet të aranzhojnë zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara dhe do të jetë përgjegjëse për organizimin e provimeve. Trajnerët duhet të kenë përvojë në trajnime të prokurimit publik, në praktikat më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.

## **Funksioni i Revokimit të Certifikatës**

Revokimi i një certifikatë profesionale të prokurimit mund të iniciohet nga:

- a. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;
- b. Organi Shqyrtues i Prokurimit; ose
- c. Çdo autoritet kontraktues.

Kërkesa për revokim të certifikatës duhet të dorëzohet në KRPP dhe duhet të dokumentohet në mënyrë të rregullt. Pas pranimit të kërkesës, KRPP-ja themelon një komision për të shqyrtuar rastin dhe dorëzon kërkesën e tillë dhe dokumentacionin përkatës tek komisioni. Komisioni shqyrton rastin dhe ka të drejtë të kërkojë informacion, sqarime dhe/ose dokumentacion të mëtejshëm nga autoriteti që ka paraqitur kërkesën, në rast se dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i pakompletuar apo jo i kënaqshëm. Pas shqyrtimit, komisioni jep mendimin e vet të dokumentuar të Bordi të KRPP-së. Bordi mund të kthejë mendimin e paraqitur tek komisioni në rast se dokumentacioni konsiderohet i pakompletuar apo jo i kënaqshëm. Bordi i KRPP vendos në bazë të kërkesave të përcaktuara në nenin 23 të LPP-së. Në rast se kërkesat e përmendura nuk janë plotësuar, KRPP-ja do të revokojë certifikatën në përputhje me procedurat e përmendura në paragrafin 8 të nenit 25 të LPP-së. Vendimi i Bordit të KRPP-së i komunikohet organit që ka paraqitur kërkesën e revokimit dhe Zyrtarit përkatës i Prokurimit. Nëse mbajtësi i certifikatës nuk është nëpunës civil, personi në fjalë gëzon të

drejtën që të njoftohet paraprakisht me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj. Nëse personi është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Nëse mbajtësi i certifikatës është nëpunës civil, autoriteti përkatës do të fillojë procedurat e nevojshme në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Zyrtari i prokurimit të cilit i është revokuar certifikata mund të fillojë trajnimin bazik të prokurimit publik, pas një periudhe njëvjeçare nga revokimi.

KRPP në strukturën e saj organizative ka gjithësej pesë divizione, katër prej të cilave kryejnë funksionet në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me nenet 25, 81, 87 dhe 88 këtë ligj, si në vijim:

### **DIVIZIONI I RREGULLAVE:**

Në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Divizioni i Rregullave kryen funksionet si në vijim:

- Vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-se nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilës nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të LPP-se; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara nga LPP si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-se për prokurim;
- Përgatitë dhe shpërndan doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas LPP-se në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- Ofron ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të LPP-se si dhe për çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- Nxjerrë dhe publikon interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- Zhvillon rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese;
- Studion Raportet e monitorimit dhe rekomandimet tjera dhe bashkëpunon ngushtë me Divizionin e Monitorimit, për përmirësimin e rregullave të sistemit të prokurimit publik dhe/ose të ligjit;

- Nxjerrë, pas bashkëpunimit të ngushtë me Divizionin e Teknologjisë së Informacionit, rregulla në lidhje me e-prokurimin, dhe më konkretisht transmisionin elektronik të dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për pjesëmarrje dhe pranimin e propozimeve. Këto rregulla duhet të përfshijnë një nënshkrim të avancuar elektronik, në pajtim me standardet ndërkombëtare;

Përveç funksioneve të autorizuar me ligj, Divizioni i Rregullave kryen edhe këto funksione shtesë:

- Mbështetë punën e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, duke kryer analiza ligjore gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit dhe legjislacionit dytësor nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik;
- Mbikëqyrë pranimin e kërkesave dhe dokumenteve të bashkangjitura të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik, vlerëson nëse nevojitet kompletim apo sqarim dhe shqyrton opinionin e mundshëm ligjor në bashkërendim me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion;
- Cakton dhe mban takime për konsulta, ndihmë teknike dhe këshilla sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik në bashkërendim me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion;
- Harton opinione, interpretime ligjore dhe këshilla lidhur me rastin që është objekt i kërkesës për interpretim ligjor;
- Siguron shpërndarjen e përgjigjes me shkrim përmes arkivit të KRPP-së pasi që e njëjta të jetë nënshkruar nga eksperti i prokurimit (hartuesi), anëtari i bordit përgjegjës për divizion dhe kryetari i KRPP-se; siguron shpërndarjen e përgjigjes përmes postës elektronike, si dhe në bashkërendim me anëtarin e bordit përgjegjës për divizion dhe kryetarin siguron publikimin në uebfaqen e KRPP-së nëse për të njëjtën konsiderohet si pyetje e shpeshtë apo si një zgjidhje e problemit të mundshëm të ballafaqimit edhe të autoriteteve tjera kontraktuese;
- Mbanë takime për: a) Bashkërendim të punëve të divizionit; b) Diskutim të çështjeve ligjore me kryetarin dhe anëtarin e bordit përgjegjës për divizion lidhur me kërkesat për interpretim të parashtruara nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik përmes arkivit të KRPP-së dhe postës elektronike në E-MAIL-in zyrtar [info.krpp@rks-gov.net](mailto:info.krpp@rks-gov.net); c) Konsulta me Bordin e KRPP-së, Udhëheqësit e Divizionit të Monitorimit dhe të Divizionit të TI-së lidhur me funksionimin efektiv dhe efikas të KRPP-së për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.



## **DIVIZIONI I MONITORIMIT:**

Në bazë të nenit 88 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Divizioni i Monitorimit kryen funksionet si në vijm:

- a) sipas planit;
- b) sipas rastit; dhe
- c) duke i përcjellur njoftimet.

### a) Monitorimi i planifikuar i prokurimit

- Përgatit çdo vit një plan të punës për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit të identifikuar për monitorim ex-post dhe të menaxhimit të kontratës të autoriteteve kontraktuese të përzgjedhura dhe të njëjtin e dorëzon tek Bordi për miratim;
- Monitoron aktivitetet e kryera të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave aktiviteteve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese me qëllim të verifikimit nëse është zbatuar në mënyrë të drejtë LPP, dhe aktet nënligjore, nga inicimi i një aktiviteti të prokurimit deri në realizimin e plotë të kontratës, në përputhje me planin vjetor të punës;
- Në raste të konstatimit të shkeljeve të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues, organizon një takim, me pjesëmarrje të personave përgjegjës për të diskutuar rastin, shpjegoj, sqaroj dhe të elaboroj masa të cilat do të ndërmerren;
- Dërgon raportet e monitorimeve të planifikuara, te: i. Zyrtari përgjegjës i prokurimit të autoritetit kontraktues përkatës; ii. të organi përkatës për mbikëqyrje (Kryetari i komunës në raste të komunave, Ministri dhe Sekretari Permanent në raste të ministrive përkatëse, Drejtorët/Udhëheqësit më të lartë të ndërmarrjeve publike etj.); dhe iii. në Divizionin e Teknologjisë së Informacionit në mënyrë që të publikohen në webfaqe të internetit të KRPP-së.

### b) Monitorimi i prokurimeve sipas rastit

- Kryen monitorim sipas rastit të një aktiviteti të prokurimit në implementim e sipër dhe i përfunduar, përfshirë këtu edhe kohën gjatë realizimit të kontratës, në autoritetet kontraktuese të zgjedhura, bazuar në informacionin e pranuar nga autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik apo palët e treta të pranuar nga KRPP;

- Monitoron ekzistencën dhe kompletimin e dosjes së tenderit para publikimit të njoftimit të kontratës (*Kjo dispozite nuk aplikohet në rast të shfrytëzimit të platformës elektronike*);
- Nxjerrë këshilla profesionale në rastet kur konstaton se një aktivitet i prokurimit i autoritetit kontraktues nuk është në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin dytësor dhe në veçanti në rastet kur autoriteti kontraktues nuk ka dokumentuar vendimin(et);
- Në raste të konstatimit të shkeljeve të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues, organizon një takim, me pjesëmarrje të personave përgjegjës për të diskutuar rastin, shpjegoj, sqaroj dhe të elaboroj masa të cilat do të ndërmerren. Raportet e monitorimeve sipas rastit e) Dërgon raportet e monitorimeve sipas rastit, te: i. Zyrtari përgjegjës i prokurimit të autoritetit kontraktues përkatës, ii. Operatori ekonomik, në rast se aplikohet; iii. te organi përkatës për mbikëqyrje (Kryetari i komunës në raste të komunave, Ministri dhe Sekretari Permanent në raste të ministrive përkatëse, Drejtorët/Udhëheqësit më të lartë të ndërmarrjeve publike etj.); dhe iv. në Divizionin e Teknologjisë së Informacionit në mënyrë që të publikohen në ueb-faqe të KRPP-së.

c) Monitorimi duke i përcjellur njoftimet

- Autoritetet kontraktues njoftojnë KRPP, për rastet në vijim: a) autoriteti kontraktues ka vendosur të përdorë procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë (sipas Nenit 35 paragrafi 1 të LPP-se), b) autoriteti kontraktues ka vendosur të anulojnë procedurën e prokurimit për arsye të çmimit abnormalisht të ulët (sipas Nenit 61 paragrafi 5 të LPP-se).
- Monitoroj cilindo nga rastet e përmendura më lart (neni 9.4.3.1), pas vendimit të Udhëheqësit të Divizionit të Monitorimit, duke i ftuar, kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese në fjalë për të rishikuar vendimet e tyre. KRPP-ja duhet të bëjë këtë brenda dy (2) ditë pas marrjes së këtij njoftimi. 9.4.3.3 Nxjerr këshilla profesionale për autoritetin kontraktues, kur KRPP, konstaton se një aktivitet i tillë i autoritetit kontraktues nuk është në përputhje me LPP dhe legjislacionin dytësor dhe në veçanti në rastin kur autoriteti kontraktues nuk e ka arsyetuar(dokumentuar), plotësisht vendimin(et) e tij. Opinionet e KRPP-së të lëshuara në përputhje me paragrafin 9.4.3.1 (a), kanë karakter jodetyrues për autoritetet kontraktuese, por autoritetet kompetente mund ti marrin ato në konsideratë gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura në përputhje me Pjesën IX të këtij ligji.
- Te gjitha njoftimet, sipas mostrave, të dorëzuara në KRPP nga

- autoritetet kontraktuese kontrollohen gjatë periudhës 2-ditore para publikimit. Gjatë kësaj periudhe Divizioni i Monitorimit nxjerrë rekomandime me shkrim drejtuar Autoritetit kontraktues për korrigjimin e gabimeve ose mangësive. Autoriteti kontraktues do të publikojë dhe qarkullojë korrigjimet;
- Të gjitha njoftimet e dorëzuara në KRPP përmes sistemit të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese mund të kontrollohen gjatë periudhës së publikimit deri në hapje. Gjatë kësaj periudhe Divizioni i Monitorimit mund të nxjerrë rekomandime me shkrim drejtuar Autoritetit kontraktues për korrigjimin e gabimeve ose mangësive. Autoriteti kontraktues ka përgjegjësi të plotë për të vendosur se si të merr parasysh këto rekomandime;
  - Zhvillon dhe miraton metodologjinë e nevojshme dhe manualin për monitorimin e pajtueshmërisë dhe matjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë dhe përcakton treguesit relevant sasior dhe cilësor për të matur performancën dhe pajtueshmërinë me ligjin të autoriteteve kontraktuese dhe stafit të prokurimit, si dhe për të vlerësuar në tërësi sistemin kombëtar të prokurimit publik;
  - Zbaton metodologjinë e mësipërme dhe manualin duke zhvilluar një plan të punës; duke vazhduar me mbledhjen e të dhënave në terren përmes pyetësorëve ose metodave të tjera; vendosjen e të dhënave në një bazë të dhënave për analiza; vlerësimin e vlerave të indikatorëve ose informacione të tjera relevante cilësore; raportimin e të gjitha gjetjeve tek Bordi i KRPP-së në baza të rregullta dhe integrimin e tyre në raportet e KRPP-së; mbështetja e çdo veprimi që rrjedh nga gjetjet e performancës dhe të pajtueshmërisë;
  - Përgatitë dhe elaboron raportet vjetore të pajtueshmërisë dhe performancës që identifikojnë përparësitë dhe mangësitë në implementimin e Ligjit, në sistemin e prokurimit publik dhe implementimin e aktiviteteve të kontratave. Raportet do t'i paraqiten Bordit të KRPP-së për hapat e mëtejshëm në përgatitjen e një strategjie për të rritur performancën e zbatimit të sistemit të prokurimit publik, si dhe rekomandimet për përmirësim;
  - Elaboron dhe dorëzon tek Divizioni i rregullave, Divizioni i trajnimeve dhe Integritimeve Evropiane çdo rekomandim për përmirësim në sistemin dhe/ose Ligjin e prokurimit publik, me theksim të veçantë në aktivitetet e prokurimit.

## **DIVIZIONI I TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE:**

Në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Divizioni i trajnimeve dhe Integritimeve Evropiane kryen funksionet si në vijim:

- Zhvillon module të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim për trajnimin Themelor dhe të Avansuar (Nivelin Qendror dhe Lokal, OE, OJQ) duke përgatitë katalogun, programet, modulet për trajnime, të cilat aprovohen nga Bordi i KRPP –se;
- Harton një listë të dokumentuar të kualifikimeve për certifikim si trajnerë dhe si pjesëmarrës në trajnimet e prokurimit. Lista e kualifikimeve publikohet në web-faqen e KRPP-se;
- Identifikon personat, me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja për Trajnim Themelor dhe të Avansuar;
- Siguron që trajnerët e përzgjedhur të jenë persona të certifikuar për trajnim dhe të jenë të trajnuar nga një institucion i trajnimeve që ka ekspertizë substanciale në praktikën më të mira ndërkombëtare të prokurimit dhe në sistemin e prokurimit të BE-së.
- Përzgjedh dhe Ripërtërin Listën e trajnerëve për çdo 5 vite nga Komisioni i Përcaktuar nga Kryetari i KRPP-se;
- Propozon angazhimin e trajnerëve nga Lista e trajnerëve për programe të trajnimit Themelor dhe të Avancuar për çdo vit në Bordin e KRPP-se;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, aranzhon zhvillimin dhe mbajtjen e kurseve profesionale të prokurimit me kohëzgjatje të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë për trajnime bazike dhe dhjetë ditë (10) për trajnime të avancuara sipas Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të KRPP- IKAP;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, është përgjegjëse për organizimin e provimeve në mbështetje të Rregullores për procedurat e zhvillimit të testeve në programet e trajnimit për Prokurim Publik;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, lëshon “certifikatën themelore profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset themelore dhe të cilët rekomandohen nga Komisioni i vlerësimit të testeve;
- Në bashkëpunim me IKAP-in, lëshon “certifikatën e avancuar profesionale të prokurimit” vetëm për personat të cilët i kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme të gjitha kurset e avancuara dhe të cilët rekomandohen nga Komisioni i vlerësimit të testeve;
- Përkrahë IKAP-in dhe autoritetet tjera publike për edukim dhe trajnim për të implementuar trajnime të nivelit të lartë për zyrtarët

- e prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit, që synojnë në implementimin e praktikave të mirëfillta të prokurimit dhe të respektimit të Ligjit;
- Është përgjegjës për elaborimin e moduleve të trajnimit mbi Prokurimin Publik dhe përtirjen e tyre, sipas nevojave të trajnimit dhe ndryshimeve në Ligjin e Prokurimit Publik dhe legjislacionin dytësor;
  - Zbaton analiza periodike të nevojave për trajnime për zyrtarët e prokurimit publik në Kosovë, operatorët ekonomik dhe për stafin e KRPP-së, në mënyrë që të definojnë nevojat e tyre për trajnime;
  - Mirëmban dhe përtërinë databazat e Autoriteteve Kontraktuese (AKtë), zyrtarëve të certifikuar të prokurimit dhe trajnerëve të certifikuar në prokurim publik;
  - Përforcon vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat.

Përveç funksioneve të autorizuar me ligj, Divizioni i trajnimeve dhe Integriteteve Evropiane kryen edhe këto funksione shtesë:

- Ofron mbështetje për pjesëmarrjen e KRPP-së në aktivitetet e procesit të integritetit evropian dhe koordinon të gjitha aktivitetet e nevojshme të kërkuara nga KRPP-ja;
- Monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në lidhje me prokurimin publik në Kosovë, dhe harmonizimin e legjislacionit përkatës me *acquis* të BE-së;
- Bashkpunon me MF dhe MIE rreth Planit Kombtar për zbatimin e MSA-se (PKZMSA) dhe raporton në baza tre mujore rreth këtij plani;
- Koordinon asistencën e IPA-se dhe ndihma të tjera të huaja për aktivitetet e KRPP-së dhe siguron që kanë të bëjnë me prioritetet e KRPP-së dhe sistemit të prokurimit publik të Kosovës;

## **DIVIZIONI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE:**

Në bazë të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Divizioni i Teknologjisë Informative kryen funksionet si në vijim:

- Mirëmban dhe është përgjegjës për administrimin e platformës së prokurimit elektronik dhe të gjitha komponentët e nevojshme hardware dhe software;
- Është përgjegjës për zbatimin e politikave, procedurave dhe rregulloreve për sigurinë e TI-se; administrimin e aplikacionit; administrimin e bazës së të dhënave; planifikimin e vazhdimësisë së biznesit; planin e menaxhimit/veprimit të rrezikut; planifikimi nga rimëkëmbja prej fatkeqësive; politika e kopjes rezervë (Backup); politika arkivore;
- Mirëmban Regjistrin Elektronik të Prokurimit Publik, si pjesë të platformës së prokurimit elektronik, që do të shërbejë si arkiv për kopje elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara apo të lëshuara në lidhje me secilin aktivitet të prokurimit të performuar apo të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
- Mbështet zhvillimin e sistemit elektronik për monitorimin e respektimit të LPP, nga autoritetet kontraktuese, përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që do të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese që i nënshtrohen ligjit;
- Mbështet zhvillimin e metodave elektronike të prokurimit, të tilla si e-prokurimi, ankandin elektronik dhe sistemin dinamik të blerjes, në përputhje me dispozitat e LPP-së;
- Mbështet prezantimin dhe përdorimin, nga të gjitha palët e përfshira, të nënshkrimit elektronik, në përputhje me standardet ndërkombëtare;

Përveç platformës së prokurimit elektronik, kryen edhe funksionet tjera:

- Oofron mbështetjen e nevojshme për sistemet tjera të TI të KRPP-së;
- Siguron funksionimin e sistemeve të TI të KRPP-së dhe për zhvillimin, integrimin, pajtueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës së TI të KRPP;
- Mirëmban faqen e internetit të KRPP, duke i siguruar publikut qasje të pa kufizuar në: a) Ligj dhe tërë legjislacionin sekondar të lëshuar nën autoritetin e Ligjit, b) çdo interpretim dhe dokumente, c) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik d) të gjitha raportet e përgatitura nga Divizioni për Monitorim, si rezultat i procedurave të monitorimit.
- Siguron këshilla dhe udhëzime të detajuara për të gjithë stafin që përdorin sistemin e TI në lidhje me dispozitat e sigurisë së TI. Këto dispozita duhet të zbatohen nga i gjithë stafi i KRPP-së, që përdorin sistemin e TI;
- Mbështet zbatimin e Politikave dhe Procedurave të Sigurisë të KRPP-së. I gjithë personeli duhet të informohet në lidhje me

legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe Politikat dhe Procedurat e mësipërme, nga legjislacioni i ASHI-së, KRPP-së dhe institucionet tjera, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe duhet ti zbatojnë ato;

- Sektori i tavolinës ndihmese i përgjigjet kërkesave për ndihmë teknike me anë të telefonit, dhe në mënyrë elektronike të gjitha Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatoreve Ekonomik, dhe i këshillojë mbi veprimin e duhur që të ndjekin procedurat standarde;
- Përcjell problemet që mund të shfaqen për të korrigjuar platformën dhe identifikon situata që kërkojnë vëmendje urgjente;
- Publikon njoftimet e pranuar nga Divizioni i Monitorimit, pasi që njoftimet të kenë kaluar procedurën e kontrollimit nga Divizioni i Monitorimit. *(Kjo dispozitë nuk aplikohet për shfrytëzuesit e platformës elektronike).*

#### **4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI**


KRPP-ja ka tridhjetë e nente (39) pozita të aprovuara . Nga këto pozita tridhjetë e gjashtë (36) janë nëpunës civil, ndërsa numri aktual i të punësuarëve në KRPP është tridhjetë e nje (31).

Nga tridhjetë e nje (31) të punësuar në KRPP njëzet e tete (28) janë nëpunës civil kurse tre (3) janë Funkionar Publik (dy (2) anëtar të Bordit dhe Kryetari i KRPP-se).

Tete (8) vende të punë janë ende të pa plotësuar.

Mandati i bordit të KRPP-se është pesë (5) vjeçarë , Kryetari dhe anëtarët e bordit të KRPP-se janë emëruar me vendimin e datës 03.08.2015 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

#### **ORGANOGRAMI:**



### Bordi i KRPP-së

Bordi i KRPP-së, është institucioni më i lartë për marrjen e vendimeve kolektive të KRPP-së. Kryetari gjithmonë është njëri nga anëtarët. Vetëm Bordi do të ketë të drejtat si në vijim:

- Të aprovojë aktet dytësore dhe çdo amendament tjetër;
- Të aprovojë dhe dorëzoj në Qeveri dhe Kuvend raportin vjetorë të punës, jo më vonë se në fund të muajit mars të vitit kalendarik të radhës, që analizon aktivitetet e prokurimit në Kosovë që ndodhin gjatë atij viti kalendarik dhe që bënë rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose ligjit aktual;
- Të aprovojë strategjitë dhe planet tjera të KRPP-së;
- Të nxjerrë udhëzime për trajtimin e dokumenteve;

Bordi i KRPP-se është përgjegjës për të organizuar dhe menaxhuar punën e divizioneve përkatëse dhe për implementimin e funksioneve



apo aktiviteteve tjera të përcaktuara nga Kryetari. Bordi i KRPP-së siguron mbështetjen teknike dhe administrative për funksionimin efektiv dhe efikas të Divizioneve. Anëtarët e Bordit të KRPP-se, janë emëruar sipas nenit 89 të LPP, dhe mund të largohen ose suspendohen vetëm sipas nenit 93 të LPP.

### **Funksionet e Kryetarit të KRPP-së**

- Kryetari përfaqëson, menaxhon dhe organizon punën e KRPP-së dhe ka përgjegjësinë e përgjithshme për performancën e punëve ditore;
- Përgjegjësia për të kryer funksionet dhe aktivitetet e KRPP-së të cilat nuk janë përcaktuar apo përfshirë në ndonjë Divizion bie mbi Kryetarin;
- Kryetari ka autoritetin që të cakton cilindo anëtar të stafit për të organizuar dhe menaxhuar punën e KRPP-së në fusha të caktuara, në veçanti funksione specifike apo aktivitete të cilat nuk janë të përfshira në funksionet apo aktivitetet e Devizionit të KRPP-së. Kryetari ka për të informuar anëtarët e Bordit për ndonjë përcaktim të tillë. Një kopje e dokumentit në lidhje me delegimin e përgjegjësive do të bartet Menaxherit të personelit, i cili do të kujdeset për dosjen dhe ti përfshijë ato përgjegjësi të deleguara herë pas here. Kryetari mund të ndryshoj këto përgjegjësi ashtu siç ai/ ajo i sheh të arsyeshme;
- Kryetari do të thërret takimet e Bordit të KRPP-së, kur dhe si ai konsideron të jetë e nevojshme apo kur kërkohet nga dy anëtarët e tjerë të KRPP-së;
- Kryetari do të udhëheq takimet e Bordit të KRPP-së. Në raste të jashtëzakonshme kur është e nevojshme që KRPP, të ketë një takim në mungesë të Kryetarit, ai duhet të autorizoj një nga anëtarët tjerë të Bordit të KRPP-së për të udhëhequr takimin;
- Aprovon listën e vendeve të punës;
- Aprovon përkrahimin e vendeve të punës;
- Përcakton detyrat e nëpunësve të KRPP-së;
- Shkarkon nënpunësit;
- Ka përgjegjësi për menaxhimin e fondeve financiare të KRPP-së;
- Përcakton një anëtarë tjetër për të prezantuar, menaxhuar, dhe organizuar punën e KRPP në mungesë të Kryetarit p.sh të ushtroj detyrën e Kryetarit. Ky person mund të ndryshojë prej një mungese në tjetrën;
- Jep udhëzime duke siguruar qarkullimin e dokumenteve brenda KRPP;
- Konkludon dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontrata të nevojshme për të kryer funksionet e KRPP-së;

- Nënshkruan dokumentet në emër të KRPP-së, nënshkruan të gjitha vendimet e arritura nga Bordi. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga KRPP, i cili nuk është nënshkruar nga Kryetari, përveç komunikimeve elektronike;
- Siguron se Rregullat e Procedurave Financiare të Ministrisë së Financave (MF) janë zbatuar nga secili punëtorë i KRPP-së, në fushat e tyre funksionale;
- Monitoron dhe kontrollon shpenzimet e KRPP-së;
- Siguron se të gjithë nënpunësit të cilët kanë përgjegjësi për administrimin financiar janë të këshilluar në mënyrën e duhur;
- Siguron se ekziston një ndarje e qartë e detyrave në mes administrimit të financave dhe kontrollit adekuat.

### **Funksionet e anëtarit të Bordit**

- Anëtari i Bordit merr përsipër përgjegjësinë e Divizionit nën përgjegjësinë e tij në të gjitha fushat e funksionimit të tij, duke përfshirë, ndër të tjera, çështjet organizative, punën dhe produktet e punës;
- Propozon përshkrimet e vendeve të punës për Udhëheqësin e Divizionit;
- Cakton detyrat për Udhëheqësin e Divizionit;
- Nënshkruan dokumentet e lëshuara nga Divizioni. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga Divizioni, i cili nuk është nënshkruar nga anëtari i Bordit, përveç komunikimeve elektronike.

## **5. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2017**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik. Gjatë vitit 2017 në Kosovë janë evidentuar 163 autoritete kontraktuese që kanë krye prokurime, ndërsa për 16 autoritete kontraktuese prokurimet i ka krye Agjencioni Qendror i Prokurimit.

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2018, i kanë dërguar në mënyrë elektronike pran divizionit të monitorimit, ky divizion pra i ka pranuar dhe ka kontrolluar keto raporte të dërguara nga autoritetet kontraktuese.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2017 në tërë Kosovën janë nënshkruar 10214 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2017. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kritereve të shpërblyer me kontratë.

Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2017 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

## 5.1. NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2017


| NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA |           |           |           |                        |
|-----------------------------------|-----------|-----------|-----------|------------------------|
| Autoritetet kontraktuese:         | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 <sup>1</sup> |
| Qeveritare                        | 9053      | 8676      | 8194      | 7452                   |
| Kompani publike                   | 2295      | 2194      | 1806      | 2751                   |
| Tjera/OJQ                         | 14        | 25        | 15        | 11                     |
| Gjithsej:                         | 11362     | 10895     | 10015     | 10214                  |

**Tabela 1**

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

Analizën e kontratave të nënshkruara po e fillojmë me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – Qeveritare, Kompani publike dhe të Tjera-OJQ. Duke u bazuar në këtë ndarje, do të pasqyrojmë numrin e kontratave të nënshkruara në tabelën nr. 1 dhe në grafikun nr. 1 gjatë katër viteve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.

<sup>1</sup> Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 243 aneks kontrata.



**Grafikoni 1**

## 5.2. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2017


| VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA (€) |                         |                         |                         |                                      |
|---------------------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|--------------------------------------|
| Autoritetet kontraktuese              | Vlera e kontratave 2014 | Vlera e kontratave 2015 | Vlera e kontratave 2016 | Vlera e kontratave 2017 <sup>2</sup> |
| <b>Qeveritare</b>                     | 259,686,575.89          | 250,256,843.43          | 359,747,327.33          | <b>354,478,891.29</b>                |
| <b>Kompani publike</b>                | 129,579,279.93          | 149,816,528.31          | 62,063,637.36           | <b>103,084,640.60</b>                |
| <b>Tjera/OJQ</b>                      | 472,102.78              | 1,770,253.36            | 2,763,414.33            | <b>2,226,414.05</b>                  |
| <b>Gjithsej :</b>                     | <b>389,737,958.60</b>   | <b>401,843,625.10</b>   | <b>424,574,379.02</b>   | <b>459,789,945.94</b>                |
| Autostrada <sup>3</sup> :             | 55,468,528.85           | 114,577,050.00          | 155,978,020.17          | 181,508,615.54                       |

**Tabela 2**

<sup>2</sup> Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera e aneks kontratave në vlerë prej 3,948,573.87€

<sup>3</sup> Kontrata: Autostrada Prishtinë- Hani i Elezit, Rruga 6, Pjesa e parashikuar gjatë vitit 2014 prej 55,468,528.85€ dhe gjatë vitit 2015 prej 114,577,050.00€, 2016 prej 155,978,020.17 dhe gjatë vitit 2017 181,508,615.54€ nga M Infrastruktura.


Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lartë në tabelën nr.2 dhe grafikun nr.3 pasqyrohet vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë katër viteve të fundit.



### Grafikoni 3

Grafikoni nr.4 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2017. Organizatat buxhetore - Qeveritare marrin pjesë me 77.10%, Kompanitë publike me 22.42%, derisa te autoritetet Tjera – OJQ-të me vetëm 0.48% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.

**Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2017 sipas llojit të vlerës së prokurimit**



**Grafikoni 4**


**NUMRI TOTAL DHE LLOJET E NDRYSHMTE TE AUTORITETEVE KONTRAKTUESE**

| AUTORITETET KONTRAKTUESE |                             | NR         |
|--------------------------|-----------------------------|------------|
| 1                        | Niveli qendrorë             | 60         |
| 2                        | Niveli lokal                | 74         |
| 3                        | Ndërmarrje publike qendrore | 16         |
| 4                        | Ndërmarrje publike lokale   | 10         |
| 5                        | <u>Ndërmarrje shoqërore</u> | 2          |
| 6                        | <u>Tjeter/OJQ</u>           | 1          |
|                          | <b>Gjithsejt:</b>           | <b>163</b> |

**Tabela 2.1**


**PJESËMARRJA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË BRUTO PRODUKTIN VENDOR (BPV<sup>4</sup>=6,252,203,000.00) GJATË VITIT 2017**

**PJESËMARRJA E VLERËS SË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË BRUTO PRODUKTIN VENDOR GJATË VITIT 2017**



**Grafikoni 4.a**

Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara ( duke e shtuar edhe pjesën e autostrades të parashikuar për vitin 2017 prej 181,508,615.54 ) në Bruto Produktin Vendor



**Grafikoni 4.b**

<sup>4</sup> Burimi: Ministria e Integrimit Evropian



**NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE PERMES PROCEDURAVE TE PROKURIMIT MBI PRAGJET FINANCIARE TE BE-së**

| NUMRI TOTAL DHE VLERA FINANCIARE E KONTRATAVE VJETORE PERMES PROCEDURAVE TE PROKURIMIT MBI PRAGJET FINANCIARE TE BE-SË |                     |                     |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------|
| Lloji i kontratave:                                                                                                    | Vlera e kontratave: | Numri i kontratave: |
| Furnizime: (Mbi 144.000,00)                                                                                            | 112,878,664.72      | 143                 |
| Shërbime: (Mbi 144.000,00)                                                                                             | 33,127,486.03       | 67                  |
| Konkurs i projektimit: (Mbi 144.000,00)                                                                                | 248,000.00          | 1                   |
| Punë: (Mbi 5 548.000,00)                                                                                               | 29,678,638.81       | 2                   |
| Gjithsejt:                                                                                                             | 175,932,789.56      | 213                 |

**Tabela 2a**


**5.3. VLERA E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA GJATË VITIT 2017 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT**

| VLERA E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT (€) |                         |                         |                         |                         |
|-------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Burimet e financimit:                                             | Vlera e kontratave 2014 | Vlera e kontratave 2015 | Vlera e kontratave 2016 | Vlera e kontratave 2017 |
| Të hyrat vetanake <sup>5</sup>                                    | 129,808,495.46          | 147,482,211.85          | 60,066,595.11           | 97,873,515.49           |
| Buxheti i Kons. i Kosovës                                         | 258,872,264.05          | 251,046,795.73          | 352,092,401.45          | 351,580,882.16          |
| Donacione                                                         | 1,057,198.09            | 3,314,617.52            | 12,415,382.46           | 10,335,548.29           |
| Gjithsej :                                                        | 389,737,957.60          | 401,843,625.10          | 424,574,379.02          | 459,789,945.94          |
| Autostrada:                                                       | 55,468,528.85           | 114,577,050.00          | 155,978,020.17          | 181,508,615.54          |

**Tabela 3**

<sup>5</sup> Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e Kompanive Publike.


|    | AUTORITETET<br>KONTRAKTUESE:         | PROCEDURA E<br>PËRDORUR                           | PËRSHKRIMI I KONTRATËS                                                                                                                                                                                                  | VLERË E<br>KONTRATËS (€) |
|----|--------------------------------------|---------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| 1  | Korporata Energjetike e Kosovës      | Procedurë e Hapur                                 | Riparimi i shiritave magjstral drejtimi TC Kosova "B"                                                                                                                                                                   | 19,443,051.70            |
| 2  | Ministria e Administratës Publike    | Procedurë e Hapur                                 | Furnizim me licenca te Microsoft-it                                                                                                                                                                                     | 11,474,344.09            |
| 3  | Korporata Energjetike e Kosovës      | E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës | BLERJA E PJESEVE REZERV PËR RIPARIMIN E TURBINËS NË TC KOSOVA B Lot 1: Blerja e pjesëve te nevojshme për riparimin e turbinës se njësisë B1 Lot 2: Blerja e pjesëve te nevojshme për riparimin e turbinës se njësisë B2 | 10,481,943.80            |
| 4  | Ministria e Shëndetësis              | Procedurë e Hapur                                 | "Ndertimi i Spitalit Regjional ne Ferizaj"                                                                                                                                                                              | 10,235,587.11            |
| 5  | Telekomi i Kosoves Sh.A              | E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës | Furnizimi me pajisje dhe pune per zgjerimin dhe modernizimi i rrjetit broadband                                                                                                                                         | 5,816,616.19             |
| 6  | Agjencia Qendrore e Prokurimit       | Procedurë e Hapur                                 | F. ME DERIVATE TE LENGETA. Lot I                                                                                                                                                                                        | 5,743,150.10             |
| 7  | Ministria për Komunitete dhe Kthim   | Procedurë e Hapur                                 | "Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit"                                                                                                                                                                      | 4,477,272.11             |
| 8  | Korporata Energjetike e Kosovës      | Procedurë e Hapur                                 | LOT 1- Furnizim .demonitim . montim dhe komisionim i reduktorve te pompes furnizuese per bllokun A3/A4                                                                                                                  | 4,197,020.46             |
| 9  | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarise | Procedurë e Hapur                                 | Furnizim me pajisje per asgjesimin e mbetjeve shtazore                                                                                                                                                                  | 3,899,500.00             |
| 10 | Korporata Energjetike e Kosovës      | Procedurë e Hapur                                 | Shërbimet e sigurimit shëndetësor për punëtorët e KEK sh.a                                                                                                                                                              | 3,680,654.40             |
| 11 | Ministria e Administratës Publike    | Procedurë e Hapur                                 | Ndertimi shkollave dhe nderteses se IKAP                                                                                                                                                                                | 3,675,971.14             |
| 12 | Ministria për Komunitete dhe Kthim   | Procedurë e Hapur                                 | "Furnizim me material ndertimor"                                                                                                                                                                                        | 3,461,554.64             |
| 13 | Korporata Energjetike e Kosovës      | Procedurë e Hapur                                 | Modernizimi i fushave ne kullën ftohëse bl.A4                                                                                                                                                                           | 3,357,191.82             |
| 14 | Komuna e Gjilanit                    | Procedurë e Hapur                                 | Rekonstruimi I stadionit te Gjilanit                                                                                                                                                                                    | 3,121,346.07             |
| 15 | Komuna Ferizaj                       | Procedurë e Hapur                                 | Asfaltimi Rahovicë - Kishnapole . Komuna Ferizaj - projekt tre vjeqarë                                                                                                                                                  | 2,648,706.65             |

*Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2017*

|           |                                                     |                   |                                                                                                     |              |
|-----------|-----------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| <b>16</b> | Ministria e Arsimit<br>Shkencës dhe<br>Teknologjisë | Procedurë e Hapur | Furnizimi me inventar për salla të<br>sportit në shkolla të arsimit<br>parauniversitar 208017031111 | 2,393,600.00 |
| <b>17</b> | Agjencia Qendrore e<br>Prokurimit                   | Procedurë e Hapur | F. ME DERIVATE TE LENGETA. Lot<br>2                                                                 | 2,338,656.26 |
| <b>18</b> | Agjencia Qendrore e<br>Prokurimit                   | Procedurë e Hapur | MARRJA E VETURAVE ME<br>QIRA.2/1. KAT.2                                                             | 2,336,004.00 |
| <b>19</b> | Agjencia Qendrore e<br>Prokurimit                   | Procedurë e Hapur | MARRJA E VETURAVE ME<br>QIRA.2/2. KAT.2                                                             | 2,336,004.00 |
| <b>20</b> | Komuna e Prizrenit                                  | Procedurë e Hapur | Menaxhimi i mbeturinave në<br>Komunën e Prizrenit                                                   | 2,215,725.60 |



## **5.15. AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK**

### **AKTIVITETET E DIVIZIONIT TË RREGULLAVE**

Që nga fillimi i vitit 2017 e deri në përfundimin e tij, Divizioni i Rregullave ka punuar për përmirësimin e akteve dytësore – rregullave dhe udhëzimeve administrative për t'i bërë ato më lehtësisht të zbatueshme për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik.

Gjithashtu, ky divizion ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në përpilimin dhe publikimin e interpretimeve në ueb-faqen e KRPP-së për problemet e ndeshura gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit publik nëpërmes Platformës elektronike të prokurimit publik, dhënien e përgjigjeve me shkrim në bazë të kërkesave me shkrim të palëve të interesuara përmes arkivit të KRPP-së dhe adresës elektronike “info.krpp”, si dhe dhënien e këshillave për prokurimin publik autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik dhe palëve tjera të interesuara qoftë përmes telefonit ashtu edhe përmes konsultave në zyren e DRR pranë KRPP-së.

### **Rezultatet e arritura**

Divizioni i Rregullave në zbatim të detyrave që e autorizon LPP dhe me qëllim të funksionalizimit të Platformës elektronike të prokurimit publik me rëndësi të veçantë sa i përket ndarjes së aktiviteteve të prokurimit në Pjesë (Lote), ndryshoi dhe plotësoi **Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për prokurimin publik**. Ky ndryshim dhe plotësim hyri në fuqi me dt. 01.06.2017 dhe i njëjti në tri versionet gjuhësore u publikua në ueb-faqen e KRPP-së, përkatësisht në linkun: “Legjislacioni sekondar”.

Gjatë kësaj periudhe kohore të raportimit, Divizioni i Rregullave punoi dhe dy rregullore:

- **Rregullorja Nr. 2/2017 për Procedurat e dhënies dhe revokimit të Certifikatës profesionale për prokurimin publik**, e cila bazën kryesore e ka në paragrafin 8 të nenit 25 të LPP-së dhe në Rregulloren e Punës së KRPP-së, si dhe
- **Rregulloren Nr. 3/2017 për themelimin e strukturave koordinuese për prokurimin publik**, i cili bazën kryesore e ka në Strategjinë kombëtare të prokurimit publik 2017-2021.

Të njëjtat u aprovuan nga Bordi i KRPP-së dhe u publikuan në ueb-faqen e KRPP-së me dt. 01.06.2017.

Në bazë të kërkesave me shkrim nga shumë autoritete kontraktuese dhe Operator Ekonomik për të njëjtat çështje, gjatë vitit 2017 janë nxjerrë dhe publikuar në ueb-faqen e KRPP-së, përkatësisht në linkun: **‘Pyetjet e shpeshta’**, ka publikuar 9 interpretime ligjore, që deri më tani në total arrijnë numrin në gjithësej 57 interpretime ligjore. *(Përgjigje në pyetjet e parashtruara)*.

Gjithnjë në shërbim të funksionalizimit të platformës elektronike të prokurimit publik dhe me qëllim që të ua bëjë më lehtë të përdorshme platformën autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik, Divizioni i Rregullave punoi 6 Interpretime ligjore, të cilat pas miratimit të Bordit të KRPP-së, u publikuan në ueb-faqen e KRPP-së, përkatësisht në linkun: “Informata” për të gjitha autoritetet kontraktuese, si në vijim:

- Interpretimi Nr. 133/2017 të dt. 30.03.2017 për sqarimin e nenit 9 të LPP-së;
- Interpretimi Nr. 145/2017 të dt. 03.04.2017 për caktimin e afatit të dërgimit për publikim të FS: **“B54 Njoftim për korrigjimin e gabimeve në Njoftimet e publikuara”**;
- Interpretimin Nr. 149/2017 të dt. 05.04.2017 për dëshmitë lidhur me aftësit teknike dhe profesionale sipas nenit 69 të LPP-së;
- Interpretimin Nr. 244/2017 të dt. 23.05.2017 për nënkontraktimin;
- Interpretimin Nr. 230/2017 të dt. 25.04.2017 për kriteret e përzgjedhjes në procedurat e tenderimit; si dhe
- Njoftimin e dt. 27.02.2017 për mënyrën e komunikimit në mes të Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik.

Që nga dt. 30.10.2009, kur Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, për herë të parë themeloi “tavolinën ndihmëse” me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale, interpretime të dispozitave të ligjit dhe të legjislacionit dytësor, me kërkesë të autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe palëve tjera të interesuara çdo ditë pune në tel. + 381 (0) 38 213 709, si dhe në e-mail: info.krpp@ks-gov.net, deri më tani, është vlerësuar të funksionojë mjaft mirë, sepse me angazhimin maksimal, efikasitetin dhe shkathtësinë e tre ekspertëve të prokurimit të Divizionit të Rregullave aq sa ka në përbërje ky divizion, që nga 1 Janari e deri më 31 Dhjetor të vitit 2017, kanë arritë të ofrojnë në total 2666 këshilla profesionale/interpretime përmes arkivës së KRPP-së, adresës zyrtare (elektronike) “info.krpp”, si dhe përmes telefonit, si në vijim:

**Përgjigjet e dhëna nga Divizioni i Rregullave i KRPP-së për Autoritetet Kontraktuese dhe operatorët ekonomik gjatë periudhës 1 Janar – 31 Dhjetor 2017**

| Nr. | Mënyra e dhënies së përgjigjeve                    | Përgjigjet e dhëna në numër | Përgjigjet e dhëna për Autoritetet Kontraktuese | Përgjigjet e dhëna për operatorët ekonomik |
|-----|----------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------------|--------------------------------------------|
| 01  | Interpretime me shkrim (përmes arkivit të KRPP-së) | 30                          | 22                                              | 8                                          |
| 02  | Interpretime përmes adresës elektronike të KRPP-së | 998                         | 541                                             | 457                                        |
| 03  | Interpretime përmes telefonit zyrtar të KRPP-së    | 1515                        | 1100                                            | 415                                        |
| 04  | Takime-Konsulta                                    | 123                         | 73                                              | 50                                         |
| 05  | Totali i përgjigjeve për AK-të dhe OE-të           |                             | 1736                                            | 930                                        |
| 06  | Totali i përgjithshëm i këshillave/interpretimeve  | 2.666                       |                                                 |                                            |

Gjatë vitit 2017, Divizioni i Rregullave ka dhënë një kontribut të jashtzakonshëm edhe në implemtimin e Platformës elektronike për prokurimin publik, me ç'rast i ofroi asistencë Divizionit të TI-së pranë KRPP-së për mirëzbatimin e rregullave të prokurimit publik dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik.

**Në vitin 2016, numri i përgjigjeve në total ka qenë 2.368 këshilla dhe interpretime. Krahësuar me vitin 2016, numri i përgjigjeve në vitin 2017 është në rritje, gjë që dëshmon rritjen e besueshmërisë ndaj këtij divizioni.**

## AKTIVITETET E DIVIZIONIT TË MONITORIMIT

Departamenti i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes

Baza Ligjore

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje i KRPP-së kryen detyrat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve të prokurimit të Autoritetet Kontraktuese duke u mbështetur në nenet 81, 88.1 dhe 88.2 të LPP-së nr.04/L-042

Departamenti i monitorimit dhe mbikëqyrjes ka kompetencë, autoritet dhe përgjegjësi të vëzhgoi mbikëqyrë dhe monitoroi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP-ja sipas autorizimit të këtij ligji.

### **Përbërja e departamentit për monitorim dhe mbikëqyrje**

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje gjatë vitit 2017 ka numruar gjithsejt katrëmbdhjetë (14) punëtor, Udhëheqësin e departamentit dhe trembëdhjetë (13) zyrtar, dymbëdhjetë kanë qenë të angazhuar në monitorimin e njoftimeve për kontratë të dërguara për publikim në vebfaqen e KRPP-së, monitorimeve të aktiviteteve të prokurimit në bazë të të gjeturave në njoftimet e monitoruara dhe monitorimet sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik dhe palve të interesuara (tre prej tyre me punë provuese nga muaji MAJ).

**KRPP – Departamenti i monitorimit nga dt.19.01.2016 bënë monitorimin e njoftimeve të autoriteteve kontraktuese të dërguara për publikim në vebfaqen e KRPP-së si: njoftimeve për kontratë, njoftimeve për dhënie të kontratës, njoftimet për anulimin e aktiviteteve të prokurimit, njoftimet për nënshkrimin e kontrates dhe njoftimet tjera.**

Gjatë vitit 2017 njoftimet të cilat janë monitoruar nga departamenti i monitorimit janë si në vijim:

|                                                                   |      |
|-------------------------------------------------------------------|------|
| ○ Njoftime për kontratë                                           | 4857 |
| ○ Njoftime për dhënie të kontrates                                | 2504 |
| ○ Njoftime për anulim                                             | 669  |
| ○ Njoftime paraprake                                              | 13   |
| ○ Njoftime mbi rezultatin e konkursit të projektimit              | 14   |
| ○ Njoftime mbi konkursin e projektimit                            | 11   |
| ○ Kërkesa për shprehje të interesit                               | 04   |
| ○ Njoftim i konkursit të projektimit –hapja e ofertave financiare | 06   |
| ○ Njoftime për parakualifikim                                     | 02   |

|                                                     |      |
|-----------------------------------------------------|------|
| ○ Anulime të njoftimeve për dhënje të kontrates     | 70   |
| ○ Njoftim për informata shtesë apo përmirsim gabimi | 67   |
| ○ Ftesë për ofertim-shitje                          | 26   |
| ○ Njoftime për nënshkrimin e kontrates              | 1350 |
| ○ Njoftim i kërkesës për kualifikim – koncesion     | 1    |
| ○ Njoftime për procedurën e negociuar pa publikim   | 283  |
| ○ Njoftim për anulim të anulimit                    | 5    |
| ○ Shitja e aseteve – ankande                        | 77   |
| Gjithsejt                                           | 9959 |

### Njoftimet e publikuara sipas vlerës, të paraqitura në formë tabelare

|                                                  | Nr. i njoftimeve -<br>totali | Vlerë e Madhe | Vlerë e Mesme | Vlerë e Vogël | Vlerë minimale | Kontrat korniz<br>me një OF | Kontrat kornizë<br>me disa OF |
|--------------------------------------------------|------------------------------|---------------|---------------|---------------|----------------|-----------------------------|-------------------------------|
| Njoftime për kontratë                            | 4857                         | 237           | 1844          | 2776          |                | 334                         |                               |
| Njoftim për dhënje                               | 2504                         | 130           | 350           | 2020          | 4              | 80                          |                               |
| Njoftim për anulim                               | 669                          | 44            | 82            | 542           | 1              | 13                          |                               |
| Njoftim paraprak                                 | 13                           | 13            |               |               |                |                             |                               |
| Njo.mbi rez.e konkursit të projektimit           | 14                           |               | 14            |               |                |                             |                               |
| Njo.mbi konk.e projekimit                        | 11                           |               | 9             | 2             |                |                             |                               |
| Kërkesë për shp.interesi                         | 4                            | 1             | 3             |               |                |                             |                               |
| Nj.mbi kon.e projek.-hapja e ofertave<br>financi | 6                            |               | 1             | 5             |                |                             |                               |
| Anulimi i dhënies së kontratës                   | 70                           | 10            | 35            | 25            |                | 4                           |                               |
| Njof. Për parakualifikim                         | 2                            |               | 2             |               |                |                             |                               |
| Njo. Për infor. Shtesë ose përmirsim<br>gabimi   | 67                           | 6             | 21            | 40            |                |                             |                               |
| Ftesë për ofertim -shitje                        | 26                           | 1             | 5             | 20            |                |                             |                               |
| Njo. për nënshkrim kontrate                      | 1350                         | 47            | 109           | 679           | 515            |                             |                               |
| Njoftim i kërkesës për parakualifi-<br>koncesion | 1                            | 1             |               |               |                |                             |                               |
| Njo.për procedur.e negociuar pa<br>publikim      | 283                          | 18            | 108           | 157           |                |                             |                               |
| Anulim i anulimit                                | 5                            | 3             | 1             | 1             |                |                             |                               |
| Shitja e aseteve - Ankande                       | 77                           | 1             | 20            | 56            |                |                             |                               |
| Totali:                                          | 9959                         | 512           | 2604          | 6323          | 520            | 431                         |                               |

Siq shifet nga tabela, sikurse në vitin paraprak (2016) edhe gjatë këtij viti (2017) kemi **dallimi të madhë të njoftimeve për anulim (669) dhe**

**anulimi i dhënjes së kontratës(70) prandaj departamenti i monitorimit duhet të ketë kujdesë me këtë dukuri gjatë monitorimit për vitin 2018.**Gjthashtu nga tabela vërejmë se disa autoritete kontraktuese edhe pse sipas ligjit nuk janë të obliguara të bëjnë publikimin e njoftimeve me vlerë minimale (përveq publikimeve për nënshkrimin e kontratës) në vebfaqen e KRPP-së megjithatë i kanë dërguar për publikim njoftimet e tyre.

Vlenë të ceket se, vërejtjet-kërkesat më të numërta për korigjime nga zyrtarët për monitorim të **njoftimeve të dërguara për publikim** kanë qenë:

| Nenet e LPP-së       | Përshkrimi                                                                                           | Nr. i rasteve |
|----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| Neni 69              | Aftësit teknike dhe profesionale                                                                     | 306           |
| Neni 68.1            | Gjendja ekonomike dhe financiare(përzierja e kërkesave me dëshmi –lejkalimi I vlerës së parashikuar) | 94            |
| Neni 28.2            | Specifikimet teknike                                                                                 | 87            |
| Neni 42.2            | Publikimi i njoftimeve (nuk janë harmonizuar në të dyja gjuhët)                                      | 37            |
| Neni 52.6            | Kriteret e dhënjes së kontratës                                                                      | 37            |
| Neni 62              | Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit                                                               | 34            |
| Rregullorja dhe UOPP |                                                                                                      |               |
| Neni 16              | Numri i prokurimit                                                                                   | 56            |
| Neni 30.6            | Validiteti i sigurimit të egzekutimit për një periudhë 30 ditë pas kompletimit të kontratës          | 58            |
|                      | Nr. i zotimit të mjeteve në DNDF para publikimit për dhënje                                          | 58            |
| Neni 56.11           | Sasia apo fushëveprimi I kontratës (nuk është paraparë sasia në total                                | 47            |
| Neni 31.2            | Validiteti i tenderit                                                                                | 42            |
| Neni 18.26           | Përcaktimi i sasisë së përafërt                                                                      | 31            |
|                      | Gabime teknike                                                                                       | 161           |

**Gabimet teknike si:** mospërputhja e datave të afatet e tenderimit,numri i prokurimit, data e pranimit të dosjes së tenderit,gabimet të fjalori i prokurimit,sasia dhe fushëveprimi të njoftimeve për kontratë,mospërputhjet e të dhënave tek verzionet në gjuhën shqipe me

verzionin në gjuhën serbe etj, kanë qenë në numër të konsiderueshëm ku departamenti i monitorimit ka intervenuar për përmirësimin e tyre. Një qështje të cilës i është kushtuar një kujdesë i veçantë ka qenë njoftimi i anulimit të aktiviteteve të prokurimit dhe anulimi i dhënjes së kontratës.

Gjatë këtij viti janë monitoruar :

- 654 raste kemi njoftime për anulimin e aktivitetit të prokurimit
- 70 raste kemi njoftime për anulimin e dhënjes së kontratës

### **Njoftime për anulimin e aktivitetit të prokurimit 654 raste**

Nga monitorimet e anulimit të njoftimit për kontratë kemi evidentuar këtë gjendje:

- 195 raste nuk është dorëzuar asnjë ofertë
- 189 raste nuk ka pasur asnjë ofertë të përgjegjshme \_
- 106 raste kemi anulimin për shkak të tejkalimit të buxhetit
- 63 raste kemi anulimin para hapjes së ofertave
- 2 raste, me vendim të AK në sipas nenit 108/A paragrafi 10.2
- 52 raste me vendim të OSHP-së
- 23 raste - një dispozitë e ligjit është shkelur
- 2 raste - anulimi për shkak të gabimeve në specifikacionin teknik
- 1 rast - anulimi për shkak të humbjes së çelësit
- 1 rast - ka dështuar në formimin e komisionit vlerësues
- 3 raste - tërheqja e OE (në një rast OE fitues ka refuzuar të regjistroi përfaqësin e tij në Kosovë)
- 7 raste - Munges e mjeteve financiare (tërheqja bugjetit)
- 5 raste kemi eliminim të OE për shkak se gabimet aritmetikore më të mëdha se 2%

(ka pasur vetëm një ofertë të dorëzuar)

### **Anulimi i dhënjes së kontratës 70 raste**

- Kthimi në rivlerësim me vendim të OSHP-së 40 raste
- Kthimi në rivlerësim sipas nenit 108/A me vendim të AK 19 raste
- Anulimi dhe kthimi në ritenderim me vendim të OSHP-së në 11 raste

Ndërsa në dy (2) raste është injoruar vendimi i OSHP-së

### **Monitorimet sipas rastit – kërkesës, përgjigjet dhe vrejtjet e shqipëtuara**

Poashtu departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje në vitin 2017 ka realizuar monitorimin e **pesëdhjet e tre (53)** aktivitete të prokurimit , gjegjësisht përgjigje sipas rastit – kërkesës së AK , Operatorëve Ekonomik apo palëve të interesuara dhe ka shqiptuar nëntë(9) vërejtje

për zyrtarët përgjegjës të prokurimit, prej tyre një pezullim të certificates së profesionalizimit për prokurim.

**Njoftimet e autoriteteve kontraktuese për procedurat e prokurimit si:**

**Përdorimi i procedures së negociuar sipas nenit 35 dhe nenit 61 të LPP-së –Nr.04/L-042**

**Departamenti i monitorimit gjatë vitit 2017 nga AK ka pranuar njoftimet për këto dy procedura si në vijim:**

Neni 35–Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimeve për kontratë është shfrytëzuar

- **283** raste , prej tyre
- **161** raste, punë shtesë (deri në 10% e kontrates bazë)

Ndërsa neni 61-Tenderët jonormalisht të ulët kemi pasur:

- **18** raste ,

**Synimet e Departamentit për Monitorim dhe Mbikqyrje për vitin 2018**

Departamentit për Monitorim dhe Mbikqyrje për vitin 2017 ka planifikuar që vazhdoi me:

- Monitorimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve aktuale të prokurimit,
- Monitorimin e aktiviteteve të prokurimit sipas Planifikimit
- Monitorimin e aktiviteteve të prokurimit sipas rastit –kërkesës së Autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik dhe palëve tjera të interesuara
- Monitorimet e dosjeve të tenderit duke i përcjell njoftimet, si dhe raste tjera të cilat mund të paraqiten gjatë punës së departamentit në këtë vit kalendarik.

Departamentit për Monitorim dhe Mbikqyrje për vitin 2018 ka planifikuar të monitoroi këto autoritete kontraktuese:

- 1- Ministria e Infrastruktues
- 2- KK Kamenicë
- 3-MAP
- 4-KK Shtërpçë
- 5-KK Shtime
- 6-QKUK
- 7-KK Vushtrri
- 8-KK Prishtinë
- 9-KK Prizren
- 10-Infrakos
- 11-Ministria për Komunitete dhe kthim
- 12-ATK
- 13-AUVK
- 14-Doganat e Kosoves
- 15-Trainkos



**- Qëllimi i KRPP-së – Departamentit të monitorimit dhe mbikëqyrjes**

- Përmes monitorimit të njoftimeve të ndryshme të autoriteteve kontraktuese të dërguara për publikim në KRPP dhe monitorimeve të aktiviteteve të prokurimit, të bëhet evidentimi, parandalimi dhe eliminimi i lëshimeve eventuale që kanë të bëjnë me respektimin e ligjit të prokurimit publik dhe legjislacionit sekundar në fuqi nga autoritetet kontraktuese, ngritjes së nivelit të punës me qëllim të shfrytëzimit të drejt, transparent dhe efikas të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera.
- Të siguroi integritetin dhe përgjegjësin e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave tjerë që janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit , si dhe të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar, të paanshme dhe etike tek zyrtarët e prokurimit dhe zyrtarve tjerë të involvuar në procesin e prokurimit publik.

## **AKTIVITETET E DIVIZIONIT TË TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE**

Në bazë të nenit 25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Divizioni i trajnimeve dhe Integrimeve Evropiane gjatë vitit 2017 ka kryer **Programin e trajnimit Intensiv** – për Certifikatë Themelore Profesionale të prokurimit për 3( KRPP, OSHP,AQP ) institucionet kryesore të prokurimit publik në Kosovë.

**Programin e trajnimit të rregullt për certifikatë** Themelor Profesional për prokurim të zyrtarëve të prokurimit nga niveli Qendror, Lokal dhe Nderr. Publike, dhe gjithashtu **Programin e Trajnimit për Prokurimin Elektronik** për zyrtaret e nivelit Qendror, Lokal /Ndër.Pub, Operatoreve Ekonomik, Organizatave të shoqërisë Civile, zyrtaret tjerë të Autoriteteve të prokurimit të cilët në mënyrë direkt apo indirekte janë të përfshirë në prokurim.

Ky raport pasqyron punën një vjeçare të trajnimeve, përmban edhe **përshkrimin e moduleve të programeve të trajnimeve**, pjesëmarrjen (vijueshmërinë ) e zyrtareve të prokurimit, **monitorimin dhe mbikëqyrjen e trajnimeve , angazhimin e trajnerëve për programet e trajnimit , Testimin – Ri testimin e pjesëmarrësve të trajnimit**, licencimin ose pajisjen me certifikata themelore profesional të prokurimit.

Sipas LPP, zyrtaret përgjegjës të prokurimit dhe nëpunësit e prokurimit, fillimisht, duhet të posedojnë një certifikatë të vlefshme themelore, në mënyrë që t'u lejohet të marrin përsipër detyrat e tyre.

### **I. Programi Intensiv i trajnimit - për Certifikatë Themelore Profesionale në Prokurim**

Me datën 09 dhe 10 të muajit shkurt të vitit 2017 kemi marrë kërkesat nga tri institucionet kryesore të Prokurimit për nevojën e mbajtjes së një trajnimit të përsheptuar – Intensiv për zyrtaret/ ekspert e tyre ,ndërsa me datën 13.02.2017 janë dërguar listat me emrat e personave të cilët do të marrin pjesë në trajnim intensiv nga 3 institucionet themelore të prokurimit, KRPP,OSHP,AQP.

Me datën 14.02.2017 ka filluar **Trajnimi intensivë i përsheptuar** në të cilin kanë marrë pjesë: stafi i KRPP – 21 pjesëmarrës , stafi i AQP- 5 pjesëmarrës dhe stafi i OSHP- 7 pjesëmarrës , pra gjithsej 33 pjesëmarrës .

Trajnimi intensiv është mbajtur nga projekti PLANET ( Komisioni Evropian ) i cili projekt e ka mbështet KRPP-ne deri ne qershor te vitit 2017.

Trajnimi ka filluar ne sallën e ndërtesës se Ministrisë se Infrastrukturës, me mbajtjen e moduleve te trajnimit për programin Themelor Profesional te prokurimit publik, trajnimi sipas programit ka pasur 10 module dhe te cilët kane zgjate 15 dite për pjesëmarrësit .

Nga ky trajnim janë pajis me certifikatë Themelore Profesionale për Prokurim 33 ekspertë te organeve kryesore te prokurimit-KRPP, OSHP dhe AQP .

## **II. Programi i Rregullt i trajnimit për Certifikatë Themelore profesional në prokurim**

### **a) Njoftimi për trajnim ne web-faqe te KRPP-se**

Me datën 24.03.2017 – 11.04.2017 është bërë njoftimi ne web-faqe te KRPP-se për aplikim të pjesëmarrësve për trajnim për nivelin Qendror ,Lokal dhe Ndërmarrjet Publike te Autoriteteve Kontraktuese, sipas te cilit njoftim kane pasur te drejtën e aplikimi te gjithë zyrtaret e prokurimit te cilët nuk janë te certifikuar me certifikatë 2017-2019.

Me datën 14.09.2017 janë përpiluar grup - listat qe kane përfshi ne trajnim me se 224 pjesëmarrës, plani kalendarik dhe agjendat e trajnimit .

Trajnimi ka filluar me datën 19.09.2016 ,Trajnimi për nivelin Qendrore ka pasur 3 Grupe me nga 37 pjesëmarrës ne një grup pra me gjithsejte 111 pjesëmarrës i cili trajnim është mbajtur ne sallat e Ministrisë se Infrastrukturës.

Gjithashtu ne te njëjtën dite trajnimi ka filluar edhe ne sallën e MAP me pjesëmarrje prej 3 grupeve qe ka përfshi gjithsejte 112 pjesëmarrës.

Trajnimi ka përmbajte 6 grupe - me gjithsejte 224 pjesëmarrës , te cilët kane ndjekur 15 dite trajnim për secilin pjesëmarrës , dmth 10 module te trajnimi Bazik – Fillestar.

### **b). Përshkrimi i Moduleve për Programin Themelor Profesional :**

Programi themelor – Bazik i trajnimit dhe certifikimit në prokurim publik ofron mundësinë për përmirësimin e aftësive dhe kualifikimeve të trupës së zyrtareve të cilët menaxhojnë paranë publike përmes sistemit të prokurimit. Vijuesit e këtij programi kane fituar aftësi të veçanta të nivelit të lartë, sipas detyrave komplekse që ata pritët të kenë, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor.

Programi themelor–Bazik i trajnimit zgjat 15 ditë trajnim për secilin pjesëmarrës. Ky program ka qene i strukturuar në 10 module trajnimi si në vijim: Korniza ligjore( amandamentimi i LPP-së ), Procedurat e kufizuara, Procedurat konkurruese me negociata dhe procedurat e negocuara pa publikim, Prokurimi i shërbimeve, Integritete ne prokurimin publik, E- tenderimi, Dosja e Tenderit, Menaxhimi i kontratave, Kontratat Kornize, Ankesa dhe procedura e shqyrtimit te ankesave.

### **c). Vijueshmëria e pjesëmarrësve ne trajnim**

Me datën 06.12.2017 ka përfunduar me sukses trajnimi për certifikatë Themelore Profesional për Prokurim. Pas përfundimit te trajnimit është analizuar pjesëmarrja dhe vijueshmëria e tyre ne trajnim .

Ne nivelin Qendror gjithsejte kane marre pjesë ne trajnim 123 pjesëmarrës ; prej tyre 12 pjesëmarrës nuk kane pasur asnjë dite vijueshmëri ; 11 kane vijueshmëri me pak se 8 dite ; ndërsa 98 pjesëmarrës kane pasur vijueshmërinë e nevojshme dhe i kanë plotësuar kushtet për te ju nënshtruar testit.

Ne nivelin Lokal gjithsejte kane marre pjesë ne trajnim 142 pjesëmarrës ; prej tyre 10 pjesëmarrës nuk kanë pasur asnjë dite vijueshmëri ; 14 kane pasur vijueshmëri me pak se 8 dite ; ndërsa 125 pjesëmarrës kane vijueshmërinë e nevojshme dhe i kanë plotësuar kushtet për te ju nënshtruar testit.

### **d). Organizimi i testeve për pjesëmarrës :**

Në përfundim të programit të trajnimit është organizuar testi i vijuesve të trajnimit. Testi është dominuar nga pyetjet e hapura përmes të cilave testohen aftësitë për zgjidhjen e situatave që mbart sistemi i prokurimit dhe sfidat që mund te kenë zyrtaret në të ardhmen. Pjesëmarrësit të cilët kane arritur kalueshmëri te testit në masën mbi 51 pik janë pajisur me certifikatën e Programit themelore Profesionale te prokurimit, e cila ka validitet përdorimi për tre vjet me radhë( 2018-2020).

Gjithashtu KRPP-ja ka formuar komisionin për kontrollimin e testeve në përbërje prej 3 personave ( KRPP,IKAP ) te cilët kane kontrolluar testet e secilit pjesëmarrës nga niveli Qendror dhe Lokal dhe kanë përpiluar raportin përfundimtar sipas te cilit ka rezultuar se vetëm 2 pjesëmarrës nuk e kane arritur nivelin e duhur te kalueshmërisë.

*Gjithashtu KRPP –ja ne mbështetje te Rregullores për Trajtime konkretisht te nenit 3.3 te kësaj Rregulloreje citoj “Ri-testi organizohet jo me afër jo me larg se 30 dite kalendarike nga dita e përfundimit te testit ka*

*organizuar dhe Ri- Testin. Ne Ri-test kanë pasur te drejt te hyjnë kandidatet qe nuk kanë treguar sukses pozitiv ne test dhe ata qe për shkaqe shëndetësore apo te obligimeve te mëdha te punës e kanë pasur te pamundur te marrin pjesë ne test”.*

Divizioni i trajnimit ka organizuar Testin dhe RI- Test: Testi i pare është organizuar me datën 17.01.2018 ne te cilin kane marre pjesë 199 Zyrtare te Autoriteteve Kontraktuese , te ndara ne dy grupe nga ora 9:00 dhe 10:30 ne sallën e madhe/amfiteatrin e ndërtesës se ish-Rilindjes.

Gjithashtu Divizioni I Trajnimeve te KRPP-se ka organizuar RI-TESTIM me datën 13.02.2017 ne te cilin kane marre pjesë 26 zyrtare , ndërsa komisioni për kontrollimin e testeve për Ri-Test ka konstatuar se 24 pjesëmarrës te RI-Testit kane arritur kufirin e kalueshmërisë prej 51 pik dhe 1 pjesëmarrës nuk ka arritur te kaloj ndërsa një pjesëmarrës ka qene I pa kompletuar ne dokumentacion .

Nga analiza del se ne Test 199 pjesëmarrës e kane fituar te drejtën për te u pajisur me Certifikatë themelore Profesionale dhe nga RI-testi 24 pjesëmarrës pra gjithsejte do te pajisen me certifikuar 223 zyrtare.

#### **e). Angazhimi i trajnerëve për mbajtjen e trajnimit ;**

Kriteri i angazhimit të trajnerëve ka qenë që trajnerët të jenë specialist të fushave, te kenë eksperiencë profesionale dhe të jenë të certifikuar në shkathtësitë e trajnimeve për trajner. Synim i KRPP-se është qe te mbaj nivelin e angazhimit te trajnerëve ne masën me te lart të pjesëmarrjes .

KRPP-ja-Divizioni për trajnime për programin themelor profesional ka angazhuar një numër te caktuar trajnerësh për nivelim Qendrore dhe lokal prej 16 trajnerësh te cilët kane mbajtur 90 dite trajnim për nivelin Qendror dhe lokal , te cilët janë paguar nga IKAP/GIZ.

#### **f). Mbikëqyrja e Trajnimeve :**

Pjesëmarrësit në trajnim kanë diskutuar për praktikat më të mira dhe vështirësitë më të cilat përballen në proceset e prokurimit. Ata do të praktikojnë format dhe aplikacionet të cilat përdoren në sistemin e prokurimit. Trajnimi ka qene i pasur me shembuj dhe studime të rasteve nga praktikat vendore dhe ndërkombëtare në prokurim.

Mbikëqyrja e trajnimit është bere nga IKAP – USAID – KRPP te cilët kane mbajtur evidencat përmes formularëve te ndryshëm qe janë prodhim I IKAP-USAID dhe KRPP-se siç janë: Listat e pjesëmarrjes se personave ne trajnim , formularët e vlerësimit te organizimit te trajnimit te cilat janë

plotësuar nga pjesëmarrësit e trajnimit të cilët kanë dhënë vlerësimin e tyre për mënyrën e organizimit ,materialet e trajnimit , akomodimin dhe vlerësimin për trajnerin i cili ka mbajtur trajnimin për modul.

### **III. Programi i Trajnimit për Prokurimin Elektronik**

#### **1.Njoftimi për Trajnim - për Autoritete Kontraktues të Kosovës**

Gjate vitit 2017 – KRPP-ja ka filluar një cikël të trajnimit me një numër të madhe të pjesëmarrësve për trajnim Elektronik. Me datën 18.05.2017 deri me datën 26.05.2018 KRPP –ka bere njoftimin për pjesëmarrje ne trajnim elektronik për te gjitha Autoritete Kontraktues të Kosovës . Me datën 26.06.2017 KRPP-ja ka publikuar listat e personave të cilët janë caktuar për pjesëmarrje ne trajnime për prokurim Elektronik nga niveli Qendror nga niveli Lokal dhe nga Niveli i nderr. Publike.

KRPP-ja ka bere ndarjen e pjesëmarrësve ne grupe , kështu qe janë përcaktuar 12 grupe të cilat ne secilin grupe janë përfshirë nga 21 pjesëmarrës për nivelin Qendrore kemi pas 7 grupe , ndërsa për Nivelin Lokal kemi pas 3 grupe dhe për Nivelin e nderr. Publike kemi pas 2 grupe d.m.th. gjithsejte kane aplikuar 230 persona nga Autoritete kontraktuese.

Gjithashtu KRPP po me te njëjtën date ka publikuar ne web –faqe te KRPP-se edhe planin Kalendarik sipas te cilit ka filluar dhe është mbajtur trajnimi për te gjitha grupet qe kane vijuar trajnimin.

#### **2. Njoftimi për Trajnim - për Operatorët Ekonomik dhe Organizatat e Shoqërisë Civile**

Me datën 03.08.2017 KRPP-ja ka bere njoftimin për pjesëmarrje ne trajnim – prokurimi Elektronik , në bashkëpunim me IKAP-in, Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane dhe CiviKos-in e në mbështetje të projektit të USAID-it Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM), për organizimin e trajnimeve dy ditore për shfrytëzimin e platformës elektronike.

Trajnimet janë organizuar për të gjithë Operatorët Ekonomik (OE) dhe Organizatat të Shoqërisë Civile (OSHC) të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të interesuara për vijimin e këtij trajnimi dy ditor.

Gjithashtu KRPP-ja ka njoftuar me datën 14.08.2017 në bashkëpunim me partneret e larte cekur ka filluar mbajtja e trajnimeve dy ditore me datë 16.08.2017 dhe ky trajnim është organizuar për të gjithë Operatorët

Ekonomik (OE) dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) të cilat kane aplikuar ne e-mailin zyrtar te KRPP; [Trajnimet.krpp@rks-gov.net](mailto:Trajnimet.krpp@rks-gov.net) .

KRPP-ja ka bere ndarjen e pjesëmarrësve ne grupe dhe po me te njëjtën date ka publikuar ne web –faqe te KRPP-se, Listën e pjesëmarrësve te trajnimit, Agjendën e trajnimit dhe planin Kalendarik sipas te cilit ka filluar dhe është mbajt trajnimi për te gjitha grupet qe kane vijuar trajnimin.

### **3. Njoftimi për Trajnimi për Auditorët e brendshëm te Institucioneve publike**

Me datën 03.09.2017 KRPP-ja ka bere njoftimin për pjesëmarrje ne trajnim – prokurimi Elektronik , në bashkëpunim me IKAP-in, dhe në mbështetje të projektit të USAID-it Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM), për organizimin e trajnimeve dy ditore.

Trajnimet janë organizuar për të gjithë zyrtarët e prokurimit dhe Auditorët e brendshëm të institucioneve publike lokale dhe qendrore, auditorët e jashtëm dhe hetuesit, të cilët nuk kanë pasur mundësinë ta ndjekin këtë lloj të trajnimit të organizuar përmes thirrjeve të më hershme.

Gjithashtu KRPP-ja ka njoftuar me datën 14.09.2017 se, në bashkëpunim me partneret e larte cekur, ka filluar mbajtjen e trajnimeve dy ditore për shfrytëzimin e platformës elektronike.

KRPP-ja ka bere ndarjen e pjesëmarrësve ne grupe , kështu qe janë përcaktuar 8 grupe te cilat ne secilin grupe janë përfshirë nga 21 pjesëmarrës dhe gjithsejte kane marre pjesë 174 pjesëmarrës.

Gjithashtu KRPP po me te njëjtën date ka publikuar ne web –faqe te KRPP-se, Listën e pjesëmarrësve te trajnimit, Agjendën e trajnimit dhe planin Kalendarik sipas te cilit ka filluar dhe është mbajt trajnimi për te gjitha grupet qe kane vijuar trajnimin .

### **4. Njoftimi për Trajnimi për Anëtarët e komisioneve për vlerësimin dhe happe te aktiviteteve të prokurimit**

Me datën 11.10.2017 KRPP-ja ka bere njoftimin për pjesëmarrje ne trajnim – prokurimi Elektronik , në bashkëpunim me IKAP-in, dhe në mbështetje të projektit të USAID-it Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM), për organizimin e trajnimeve dy ditore për shfrytëzimin e platformës elektronike.

Trajnimet janë organizuar për të gjithë zyrtarët e prokurimit dhe për Anëtarët e komisioneve të prokurimit në procese të hapjes dhe vlerësimit të ofertave të nivelit komunal, të cilët nuk kanë pasur mundësinë ta ndjekin këtë lloj të trajnimit të organizuar përmes thirrjeve të më hershme.

Gjithashtu KRPP-ja ka njoftuar me datën 03.11.2017 se ka filluar mbajtjen e trajnimeve dy ditore për shfrytëzimin e platformës elektronike. KRPP-ja ka bere ndarjen e pjesëmarrësve ne grupe , kështu qe janë përcaktuar 6 grupe te cilat ne secilin grupe janë përfshirë nga 21 pjesëmarrës dhe gjithsejte kane marre pjesë 134 pjesëmarrës .

Gjithashtu KRPP po me te njëjtën date ka publikuar ne web –faqe te KRPP-se, Listën e pjesëmarrësve te trajnimit, Agjendën e trajnimit dhe planin Kalendarik sipas te cilit ka filluar dhe është mbajt trajnimi për te gjitha grupet qe kane vijuar trajnimin .

### **5.Njoftim për Trajnim për Operatorët Ekonomik (OE) të ndërmarrjeve të vogla, të mesme (NVM) dhe të mëdha**

Me datën 08.12.2017 KRPP-ja ka bere njoftimin për pjesëmarrje ne trajnim – prokurimi Elektronik , në bashkëpunim me IKAP-in, e në mbështetje të projektit të USAID-it Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM), për organizimin e trajnimeve dy ditore për shfrytëzimin e platformës elektronike. Trajnimet janë organizuar për të gjithë Operatorët Ekonomik (OE) të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe të mëdha të regjistruara në Republikën e Kosovës, të interesuara për vijimin e këtij trajnimi dy ditor.

Gjithashtu KRPP-ja ka njoftuar me datën 12.02.2018 se, në bashkëpunim me partneret e cekur me larte se trajnimi do te filloj me datën 13.02.2018 për te gjithë OE të cilat kane aplikuar ne e-mailin zyrtar te KRPP; [Trajnimet.krpp@rks-gov.net](mailto:Trajnimet.krpp@rks-gov.net) .

### **Përshkrimi i programit te trajnimit për Prokurim Elektronik – E/ tenderimi**

Programi i trajnimit praktik për prokurim Elektronik ofron mundësin për përmirësimin e aftësive dhe kualifikimin e trupës se zyrtareve te cilët menaxhojnë , monitorojnë dhe kontrollojnë paranë publike përmes platformës elektronike te sistemit.

Vijuesit e këtij programi kane fituar aftësi te veçanta te niveli te larte për praktikimin e shume detyrave komplekse qe ata pritët ti kenë ne platformën e prokurimit;

Modulet e këtij programi kane përfshirë demonstrimin praktik te shembujve qe kane te bëjnë me : Regjistrimin e Operatorëve Ekonomik



ne platformë elektronike, Përgatitjen e dosjeve të tenderit për punë , furnizime dhe shërbime, Përgatitjen e ofertës dhe dorëzimin e saj përmes platformës në Autoritete kontraktues, Procesin e hapjes dhe të Vlerësimit të aktiviteteve të prokurimit , përgatitjen e njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimit për nënshkrim të kontratës përmes platformës elektronike , si dhe parashtrimin të kërkesave për sqarime të dosjeve të tenderit në AK , kërkesave për rishqyrtim në AK dhe paraqitja e Ankesave përmes platformës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Ky program ka qenë i strukturuar në grupe të pjesëmarrësve të trajnimit ku secili grup ka demonstruar praktikisht për dy ditë një shembull të aktivitetit të prokurimit në platformë prej fillimit e deri të publikimi i nënshkrimit të kontratës në web-faqe të KRPP.

Gjithashtu IKAP-i ,UASID dhe KRPP është kujdesur për akomodim të pjesëmarrësve dhe shpërndarjen e listave për pjesëmarrës dhe formularëve të vlerësimit në përfundimin të trajnimit për çdo grupi. Duke analizuar formularët e vijueshmërisë së pjesëmarrësve vërejmë se trajnimin e kanë vijuar me se 625 persona.

#### **IV. Trajnimet me partner – Bashkëpunimi**

KRPP-ja gjatë vitit 2017 ka bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare të ndryshme , ka zhvilluar dhe koordinuar aktivitet me disa organizata partnere, donator dhe institucione të vendit.

Në të gjitha këto aktivitet janë implementuar programe trajnimi për nevojat e zyrtareve të prokurimit.

Megjithatë me kapacitet **shumë të kufizuara në personel** dhe në salla trajnimi, KRPP-ja ka arritur të sigurojë përkrahje të çmuar për të plotësuar programin - planin e tij trajnues në mbështetje të USAID dhe IKAP .

Përkrahja e siguruar nga partneret ishte financimi i plot, financim i pjesshëm, në disa raste kishim edhe bashkëpunim në implementim. Organizatat me të cilat ka pasur bashkëpunim gjatë këtij viti ishin: IKAP , USAID, GIZ , PLANET etj.

Rezultatet e bashkëpunimit dhe koordinimit të trajnimeve e vërtetojnë faktin se ky vit ishte produktiv. Indikatorët e vërtetojnë se në këtë vit janë certifikuar- trajnuar 256 zyrtarë të prokurimit nëpërmjet programit themelor profesional të trajnimit dhe 625 pjesëmarrës të trajnimit për prokurim elektronik .

**Përveç trajnimit të zyrtarëve të prokurimit gjatë vitit 2017 Divizioni për trajnime dhe Integritet Evropian – KRPP –ja në**

vazhdimësi ka mbajtur takime, ka raportuar dhe bashkëpunuar sa i përket fushës së prokurimit publik me Ministrinë e Integrimeve Evropiane, Ministrinë e Financave Publike, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera.

Përmes këtyre takimeve, raportimeve dhe bashkëpunimeve është synuar që të pasqyrohet puna dhe gatishmëria e KRPP-së karshi Institucioneve Qeveritare dhe institucioneve ndërkombëtare si Zyra e BE-së, SIGMA, etj.

Kryesisht gjatë vitit 2017, Divizioni i Trajnimeve dhe Integrimeve Evropiane ka mbajtur bashkëpunim dhe raportim me këto institucione për këto pika:

- Raportime të rregullta dhe takime për Programin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së (PKZMSA).
- Takime dhe bashkëpunime për raportimet rreth zbatimit të PKZMSA-së për vitin 2017, si në matricën e raportimit ashtu edhe në dokumentin narrativ dhe rishikimin e PKZMSA-së për vitin 2018.
- Pjesëmarrës në takime për raportimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe hartimin e indikatorëve variabil për krijimin e Kontratës me BE-në, për Reformë në Menaxhimin e Financave Publike.
- Raportime dhe takime në Prishtinë dhe në Bruksel për Nën-Komitetin e MSA-së për “Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Shëndetit dhe Konsumatorit” dhe ofrimi i informacioneve shtesë të konkluzioneve të dala nga këto takime.
- Raportime dhe takime në MIE për Agjendën për Reforma Evropiane (ERA), dhe për Programin e Reformës Ekonomike (ERP) si dhe Rishikimi i Programit të Reformës Ekonomike (ERP) 2018-2020
- Raportime të rregullta në MIE për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2017,
- Raportim në Agjencinë Kundër Korrupsionit për masat e Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit, për arritjen e objektivave specifike sektoriale të përcaktuara në Strategjinë Kundër Korrupsionit, për vitin 2017
- Raportim vjetor në Vlerësimin e SIGMA-së, etj.
- Raportim në Multi Annual Plan (MAP) i cili përbëhet nga katër fusha: tregtia, investimet, lëvizshmëria dhe integrimi digjital, me raportim kam mbuluar fushën e prokurimit publik.

- Takime dhe Raportime në KIESA në pyetësin për mbështetjen e NVM-ve, për pjesën e prokurimit publik.

#### **V. Rekomandimet dhe Përfundimi :**

KRPP-ja gjatë vitit 2017 për të përmbushur detyrat e veta të cilat kanë rezultuar me një vëllim të rritur të punës në të gjitha drejtimet, ka mbështetur dhe ngritur profesionalizmin e Zyrtarëve të Prokurimit dhe personave të cilit në mënyrë direkte ose indirekte kanë qene të kyçur në prokurim në fushat kryesore të punës si në Legjislacionin e Ri të prokurimit dhe në Prokurimin Elektronik etj .

Gjatë këtij viti, në trajnimet e KRPP-se janë përfshirë Zyrtarët e prokurimit përafërsisht të mbi 150 njësive dhe organizatave publike dhe të mbi 100 Kompanive private(OE) dhe OSHC.

Përfitues të trajnimeve ishin Zyrtaret e prokurimit nga niveli Qendror, Lokal, Operatorët Ekonomik ,Organizatave të Shoqërisë Civile , Zyrtaret e prokurimit të organeve të pavarura, kompanitë publike dhe një numër i organizatave të tjera.

Sigurimi i trajnimeve kualitative dhe të përshtatur me nevojat është arritur duke u fokusuar në zbatimin e prioriteteve të dokumenteve ligjore e strategjik, përmes zbatimit të metodologjive të avancuar të mësimi për të demonstrimit të shembujve praktik për pjesëmarrësit në trajnim.

Viti 2017 është përmbyllur me certifikimi themelor profesional për prokurim të 256 zyrtareve publik dhe 625 certifikatave për pjesëmarrje në trajnim që përbën një arritje, si vlerë e veçantë e cila rrite peshën dhe imazhin e KRPP-se.

*Tabela e trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2017*

| Nr. | Lloji i trajnimit                            | Pjesëmarrësit                                                                               | Organizatorë                | Numri i pjesëmarrësve | Periudha         |
|-----|----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|-----------------------|------------------|
| 1   | Trajnime intensive për certifikatë themelore | Eksperte të prokurimit të institucioneve Qendrore të prokurimit siç janë : KRPP, OSHP , AQP | KRPP, PROJEKTI "PLANET " BE | 35                    | Shkurt-Mars 2017 |

*Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2017*

|   |                                                                               |                                                                                                                                                         |                                                                                            |     |                           |
|---|-------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|-----|---------------------------|
| 2 | Trajnimi:<br>Bazik 15 ditor<br>për certifikim<br>në prokurim<br>publik        | Zyrtarët e prokurimit<br>nga të gjitha<br>institucioneve publike<br>lokale dhe qendrore të<br>cilët nuk posedojnë<br>certifikata për prokurim<br>publik | KRPP, IKAP,<br>USAID TEAM                                                                  | 223 | Shtator -<br>Dhjetor 2017 |
| 1 | Trajnimi<br>praktik dy<br>ditor në:<br>e-prokurim                             | Zyrtarët e prokurimit<br>nga të gjitha<br>institucioneve publike<br>lokale dhe qendrore                                                                 | KRPP, IKAP,<br>USAID TEAM                                                                  | 206 | Qershor /<br>Korrik 2017  |
| 2 | Trajnimi<br>praktik dy<br>ditor në:<br>e-prokurim<br>dhe Etika në<br>biznes   | Përfaqësues të OE dhe<br>OSHC / OJQ                                                                                                                     | KRPP, IKAP,<br>USAID TEAM,<br>Oda Ekonomike e<br>Kosovës dhe Oda<br>Ekonomike<br>Amerikane | 112 | Gusht /2017               |
| 3 | Trajnimi<br>praktik dy<br>ditor në:<br>e-prokurim                             | Auditorët e brendshëm<br>të institucioneve<br>publike lokale dhe<br>qendrore, auditorët e<br>jashtëm dhe hetuesit                                       | KRPP, IKAP,<br>USAID TEAM,<br>NJQH AB                                                      | 174 | Shtator/<br>2017          |
| 4 | Trajnimi<br>praktik dy<br>ditor në:<br>e-prokurim<br>dhe Etika në<br>prokurim | Anëtarët e komisioneve<br>të prokurimit në<br>procese të hapjes dhe<br>vlerësimit të ofertave të<br>nivelit komunal                                     | KRPP, IKAP,<br>USAID TEAM                                                                  | 133 | Tetor /<br>Nëntor 2017    |
|   | TOTALI                                                                        |                                                                                                                                                         |                                                                                            | 883 | 2017                      |

## **AKTIVITETET E DIVIZIONIT TË TI-së DHE PROKURIMI ELEKTRONIK**

### **a) Aktivitetet e divizionit të TI-së**

Aktiviteti i divizionit të Teknologjisë së Informacionit me të gjitha kapacitetet është fokusuar plotësisht në:

- Administrimin e përditshëm të infrastrukturës harduerike dhe softuerike të sistemit të prokurimit elektronik, parandalim, evitim dhe zgjidhje e problemeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe operim të pandërprerë të Sistemit të Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës;
- Bashkëpunim dhe koordinim me institucionet e Ministrisë së Administratës Publike/Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë së Financave, si institucione të përfshira në mënyrë indirekte në operim të sistemit të prokurimit elektronik;
- Ofrim të shërbimeve në dhënie të ndihmës teknike dhe instruksioneve nëpërmjet tavolinës ndihmëse ( linjë telefonike, postë elektronike dhe prezencë fizike) për të gjithë përdoruesit e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik;
- Dhënie e ndihmës teknike dhe mbështetjes për të gjithë stafin e KRPP-së, divizionin e rregullave, monitorimit dhe trajnimeve, në funksion të rritjes së njohurive në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik dhe transformimit nga prokurimi tradicional në atë elektronik;
- Pasurim i dy portaleve të KRPP-së, <https://krpp.rks-gov.net/> dhe <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>, me informacione, pyetje të shpeshta, njoftime dhe vendime të përgaditura nga KRPP dhe publikuar për publikun e gjerë.

### **b) Aktivitetet nga Sistemi i Prokurimit Elektronik**

Sistemi i prokurimit elektronik i cili është vënë në operim dhe përdorim gjatë vitit 2016 ( Shtator 2016 ka qenë obligativ për të gjitha AK të nivelit qendrorë), nga data 1 janar 2017 është bërë obligativ edhe për të gjitha AK të nivelit lokal. Gjatë vitit 2017 për të gjitha AK është bërë obligative që të gjitha procedurat e hapura dhe të negociuara të prokurimit ( punë, furnizime, shërbime, konkurse projektimi, etj) me vlera të mesme dhe vlera të mëdha, të përgaditen dhe publikohen nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, ndërsa procedurat e prokurimit me vlerë të vogël dhe minimale janë lënë për t'u bërë obligative në fazën të mëvonshme varësisht nga progresi dhe rezultatet e përdorimit të sistemit.


Gjatë vitit 2017 si aktivitete kryesore të evidentuara në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik, janë:

1. Regjistrimi në vazhdimësi i përdoruesve, ku deri në fund të vitit 2017 janë evidentuar të regjistruar:

- Autoritete Kontraktuese: **185**
- Operator Ekonomik aktiv ( brenda dhe jashtë Kosovës): **4144**
- Persona Fizik/individual: **652** dhe
- Gjithësej përdorues aktiv: **10083**

2. Përgaditja procedurave të prokurimit ( dosja e tenderit dhe përshkrimi i cmimeve) dhe publikimi i të gjitha njoftimeve mbi aktivitetin e prokurimit, njoftimit për kontratë, njoftimit për dhënie të kontratës, njoftimit për nënshkrim të kontratës, njoftimit për anulim të aktivitetit, njoftim mbi korrigjimin e procedurës etj.

Statistikat mbi aktivitetin e përgaditjes së procedurave të prokurimit dhe publikimit të njoftimeve janë dhënë si me poshtë:



3. Përdorimi i sistemit te prokurimit elektronik nga operatorët ekonomik për të shkarkuar cfarëdo njoftimi të publikuar nga AK dhe cilindo nga dokumentet e tenderit, përgaditur ofertat dhe dorëzimin në menyrë elektronike nëpërmjet sistemit ose në mënyrë fizike, si dhe për të dërguar/pranuar cfarëdo njoftimi mbi aktivitetet e prokurimit.

## **6. PËRKRAHJA E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE**

KRPP, në vazhdimësi ka pranuar përkrahje në forma të ndryshme nga institucionet të ndryshme ndërkombëtare. Shumë donatorë kanë ofruar fonde në forma të ndryshme për të ndihmuar zhvillimin e këtij sistemi që nga themelimi i tij në vitin 1999, e këndeje. Këto ndihma janë ofruar në formë të asistencës teknike, përkrahjes përmes projekteve të ndryshme, organizimit të trajnimeve, këmbimit të përvojave në bazë të vizitave studiuëse, ofrimit të mundësisë për pjesëmarrje nëpër konferenca dhe seminare të ndryshëm etj.

Ndërsa gjatë vitit 2017 i vetmi donator që kanë përkrahur zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë gjatë vitit 2017 është USAID-i amerikan.

### **6.1 PËRKRAHJA NGA USAID**

Projekti i USAID-it - Përmirësimi i Kapaciteteve Administrative në fushën e Prokurimit Publik në Kosovë, është projekti i parë i cili financohet nga USAID, amerikan përmes Zyrës në Prishtinë. Ky projekt ka filluar në Dhjetor të vitit 2017, dhe parashihet që të përfundojë në fund të muajit Qershor 2022. Gjatë vitit 2017 ky projekt ka vazhduar të ndihmojë KRPP-në, objektivi i përgjithshëm i të cilit është të sigurojë administrimin e duhur të fondeve publike, transparencë dhe efektshmëri në shpenzimet publike përmes përmirësimit të sistemit të menaxhimit të financave publike dhe krijimit të një kuadri efektiv të qeverisjes publike në Kosovë dhe ndërtimin e besimit lidhur me shpenzimet publike duke rritur llogaridhënien publike. Projekti i USAID-it është në implemntim nga kompania DAI-ji dhe ka filluar të implementohet nga shkurti i vitit 2017. Qellimi kryesor i këtij projekti është ngritja e Transparencës, Efikasitetit dhe Llogaridhënies në komunat e Kosovës. Fillimisht si pilot projekt është iniciuar në pesë (%) komuna ndërsa më vonë pritet të përfshijë të gjitha komunat e vendit. Po ashtu ky projekt është duke asistuar KRPP-në në sektorin e TI-së përkatësisht ngritjen e kapaciteteve profesionale në sektorin e e-prokurimit (me angazhimin afatshkurtër të ekspertëve të TI-së).

## **6.2. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË**

Sipas Nenit 87.2.13, të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, KRPP-ja së bashku me raportin vjetor në Qeveri dhe Kuvend duhet të dorëzojë edhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji.

Me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, KRPP-ja i propozon Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe institucioneve tjera që merren me fushën e prokurimit publik, që të ndërmarrin këta hapa:

- Një rritje e vazhdueshme të përpjekjeve nga ana e autoriteteve kontraktuese me qëllim Implementimin e plotë të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 i amandamentuar ;
- Duke pasqyruar faktin se përdorimi i plotë i platformës elektronike (prokurimi elektronik) e ka shëndrruar KRPP-në në një ofrues të shërbimeve për të gjitha palët e interesit në fushën e prokurimit publik (autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik, shoqëritë civile, mediat, publikun e gjere etj.), KRPP ka nevojë për përkrahje me të theksuar dhe në kordinim të plotë ndërinstitucional me qëllim të zbatimit sa më gjithëpërfshirës të prokurimit elektronik. Për këtë qëllim KRPP ka nevojë për përkrahje të vazhdueshme në shumë aspekte e veqanësisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike. Procesi i zhvillimit të sistemit të prokurimit elektronik është një proces dinamik i cili kërkon mirëmbajtje dhe avancim të vazhdueshëm e njëkohsisht edhe kapacitete profesionale dhe teknike si dhe kapacitetet financiare të disponueshme në kohë me qëllim që të ruhet vazhdimësia e ofrimit të këtyre shërbimeve (e-prokurimit). Andaj, zgjedhja e një modeli të financimit të qëndrueshëm për KRPP-në është zgjedhja më e adekuate dhe e vetme e cila siguron vazhdimësinë e sigurt të funksionimit normal të prokurimit elektronik. KRPP, konsideron se përdorimi i modelit të **vet-financimit** tashmë të njohura dhe të përdorura nga vendet e rajonit (si Maqedonia, Kroacia etj.) apo edhe në shumë vende tjera të botës është zgjedhja më e adekuate.



- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare në fushën e prokurimit publik e sidomos përmbushja e palnit të veprimeve nga strategjia e të cilat ende nuk janë përmbushur;
- Vazhdimi i trajnimeve nga fusha e prokurimit publik edhe për grupe tjera të ndryshme, si p.sh. për stafin e nivelit menaxhues, për ekspert teknik të cilët përgatisin specifikimet teknike, për auditoret e përgjithshëm si dhe ata të brendshëm, etj. Në këtë drejtim rritja e përkrahjes edhe me të madhe për IKAP-it dhe KRPP-se nga ana e institucioneve përkatëse duhet të bëhet.
- Fokusi më i madh në menaxhimin e kontratave, nga të gjitha palët e përfshira sidomos nga autoritetet kontraktuese dhe Zyrtarët kryesorë Administrativ, por edhe për stafin teknik dhe të tjerë të përfshirë në zbatimin e kontratës;
- KRPP, gjithnjë duke u bazuar në të dhënat nga monitorimet e vazhdueshme të sistemit të prokurimit konsideron se procesi i reformimit të sistemit të prokurimit publik duhet të vazhdojë edhe në të.
- KRPP konsideron se ndryshimet ligjore me qëllim harmonizimi të me tej me direktivat e BE-së për prokurim publik (direktivart e reja) por edhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe evitimit të dobësive në sistemin duhen bërë. Për këtë qëllim KRPP në bashkëpunim me projektin e komisioni evropian ka iniciuar procesin e ndryshimeve ligjore. Ligji aktual i prokurimit publik ka specifikuar në detale shumë aspekte ligjore të cilat kërkojnë adaptime të vazhdueshme për të mbështetur zhvillimin dinamik të prokurimit publik. Ndryshimi i tyre përmes ndryshimeve ligjore (në Kuvend) nuk mund të përjell dinamikën e ndryshimeve në prokurimin publik. Andaj, kalimi nga një ligj tejet i detajuar dhe jo dinamik në kuptimin e ndryshimeve është edhe më i rëndësishëm nder rekomandimet kryesore nga ekspertët të fushës së prokurimit publik. Për këtë qëllim KRPP konsideron se rishkrimi i një ligji të ri për prokurim publik duke hequr nga ligji aktual shumë aspekte teknike dhe me karakter dinamik në ndryshime do të ndihmonte zhvillimin efikas të sistemit të prokurimit.
- Ndryshimet ligjore me tej do të duhen përcjell me ndryshimet në legjislacionin dytesorë të cilat KRPP do të bëjë në mbështetje të autorizimeve të veta. Këto ndryshime do të kenë një impakt

thelbesore edhe ne platformën e prokurimit elektronik adnajt kosto e avancimit te kësaj platforme duket te merret ne konsiderate.

- Të vazhdohet me monitorimin e njoftimeve PARA publikimit të njoftimit të kontratës;
- Të zvogëlohet sa është e mundur përdorimi i procedurave të negociuara, si dhe kontratave me vlera të vogla dhe minimale, duke shfrytëzuar marrëveshjet publike kornizë, si dhe prokurimet e centralizuara;
- Ngritja e vetëdijes mbi prokurimin publik nëpërgjithësi e për e-prokurimin në veqanti mesin e autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomikë, institucioneve të prokurimit publik, si dhe publikut të gjerë;

Ne kuadrin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës është e nevojshme që të vazhdohet me tej të ndërmerren masa për të forcuar dhe përmirësuar:

## **1. Planifikimet e prokurimit**

**Edhe me tej duhet fokusuar në** përgatitjen në kuptimin kualitative të Planifikimeve (ato dorëzohen gati vetëm formalisht), specifikimi i qarte i secilit aktivitet sikur edhe specifikimi i tyre me planin e prokurimit dhe me buxhetin e vitit fiskal përkatës dhe viteve të tjera. Sidomos, autoritetet kontraktuese duhet kenë me shume kujdes gjatë përgatitjes së projekteve afatgjate dhe nëse aktivitetet kanë implikime buxhetore me shume se 1-vjecare.

Edhde me tej mbetet sfida për autoritetet kontraktuese për të koordinuar aktivitetet me qëllim të harmonizimit të kërkesave dhe mundësive buxhetore sikur edhe planeve të punës me buxhetin vjetor. Ky integrim i këtyre aktiviteteve do të duhej bërë me kohë dhe para dorëzimit të Planifikimeve finale të Prokurimit. Specifikimi i qarte dhe i plotë i secilit aktivitet i cili pritet të implementohet në periudhën buxhetore duhet të përcillet edhe me sigurimin e mjeteve buxhetore adekuate të aprovuara nga nivelet përkatëse. Specifikimi adekuat dhe në kohë i kërkesave nga njësitë kërkuuese, sidomos i specifikave të kërkesës por edhe i buxheti të nevojshëm për realizimin është mesazh i nevojshëm.

2. Është tejet e nevojshme që edhe më tej të punohet të forcimi i proceseve të brendshme në AK duke filluar nga njësitë kërkuese dhe ato miratuese e deri te DP me qëllim harmonizimit të aktiviteteve sidomos në fazën e përgatitjes së Planifikimit të prokurimit. Gjate fazës së monitorimit KRPP ka vazhduar edhe këtë vit të konstatoj se njësitë kërkuese nuk dorëzojnë me kohe kërkesat e tyre ose i dorëzojnë pa specifikuar në nivel të duhur ato sikur edhe japin të dhëna kontradiktore për buxhetin e nevojshëm. Në këtë mënyrë duke munguar koordinimi i aktiviteteve në sektorët e AK-ve, përgatitja e Planifikimeve të Prokurimit në të shumtën e rasteve bëhet vetëm formalisht. Një praktike e tillë duhet ndryshuar sa më shpejt.
3. **Mbajtja e regjistrave të prokurimit** - Është jashtëzakonisht e nevojshme që ky aspekt të përmirësohet shumë sidomos në pjesën e menaxhimit të kontratës (neni 55.30 i UO të PP). Me aplikimin e sistemit elektronik të prokurimit janë krijuar kushte shumë më të favorshme për mbajtjen e regjistrave të prokurimit por edhe për kundër kësaj autoritetet kontraktuese janë përgjegjëse për të zhvilluar dhe mirëmbajtur një sistem efikas të evidencave në fushën e prokurimit publik.
4. **Mbetet sfida për AK Efektiviteti** më i madhe për implementimin e tërësishëm të kontratës nga Inicimi i aktivitetit deri në përfundimin e kontratës. Në këtë drejtim rekomandohen ZKA-të dhe autoritetet kontraktuese të jenë më të fokusuar në këtë fazë e cila sipas të gjitha analizave konsiderohet faza më problematike në gjithë procesin e shpenzimeve të parasë publike.
- Menaxhimi i kontratave** - të dhënat e procesit të menaxhimit dhe implementimit të kontratave, pagesat dhe aspektet tjera të implementimit edhe më tej mbesin njëra ndër sfidat kryesore të sistemit të Prokurimit Publik dhe jo vetëm sepse është larg nivelit të duhur ligjorë dhe atij të performancës së mirë. Qeveria e Kosovës e sidomos Institucionet relevante të auditimit do të duhet të fokusohen më shumë në këtë fushë në mënyrë që të përmirësohet dukshëm pjesa e menaxhimit të kontratave dhe implementimi tyre. KRPP, edhe për kundër faktit se kjo fushë e monitorimit është e lidhur vetëm me aspektet administrative të menaxhimit, KRPP do të

fokusohet me tepër në monitorimin e pjesës së menaxhimit të kontratës. KRPP është e fokusuar në përmirësimin e regjistrimit të të dhënave nga pjesa e menaxhimit të kontratave me qëllim të krijimit të sistemit sa më funksional në aspektet e menaxhimit të kontratave. KRPP do të monitorojë sidomos pjesën mbi respektimin e kushteve të kontratës me theks të veçantë atë të përmbushjes së dinamikës dhe të aplikimit të masave ndëshkuese për mos zbatimin të kontratës. KRPP do të monitorojë dhe raportojë me kohë me mënyrën e implementimit të kontratave, dobësitë dhe të metat, të dhëna të rëndësishme si ; ndryshimet dhe variacionet në kontrata, faturimet dhe pagesat, performancën e kontraktimit etj. Pavarësisht kësaj, mbështetur në faktin se KRPP monitoron menaxhimin e kontratës vetëm ne aspektin administrativ (plotësimi i aspekteve administrative) një mbikqyrje, auditim dhe ose hetim me detaj në fushën e menaxhimit të kontratave nga institucione relevante (Auditori i brendshëm dhe ai i Përgjithshëm, Agjencia Kunder korrupsion etj ) duhen bërë.

## KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

### 7. Raporti i Përmbushjeve të Rekomandimeve;

#### Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm për Pasqyrat Vjetore Financiare 2016

| N r. | Rekomandimet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Përgjegjësia primare | Asistenta  | Data e planifikuar për përmbushje                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1    | <b>Rekomandimi 1</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve kapitale dhe për të siguruar saktësinë e regjistrit të pasurive kapitale. | <b>ZKA</b>           | <b>ZKF</b> | KRPP-ja do të angazhohet në adresimin e këtij rekomandimi në bashkëpunim me MF. Siç jeni në dijeni projekti i e-prokurimit është në vazhdimësi dhe afatet e përfundimit të këtij projekti kanë qenë të pa mundura të planifikohen në buxhetin për vitin 2015 ;2016 dhe 2017.<br><i>Plain per përmbushje ;30.12.2017</i> |
| 2    | <b>Rekomandimi 2</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të rishikojë planin e veprimit, me qëllim të përcaktimit të saktë të afateve kohore dhe stafit përgjegjës për implementimin e rekomandimeve që nuk janë zbatuar. Në fokus parësor duhet të jenë                                                                                                                                                                              | <b>ZKA</b>           |            | <b>Proces</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |

|          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |            |  |                    |
|----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|--|--------------------|
|          | rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontroleve.                                                                                                                                                                                                                                                            |            |  |                    |
| <b>3</b> | <b>Rekomandimi 3</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave të identifikuara me dobësi. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit të vetvlerësimit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.   | <b>ZKA</b> |  | <b>31.12. 2017</b> |
| <b>4</b> | <b>Rekomandimi 4</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se është kryer një rishikim specifik për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017. | <b>ZKA</b> |  | <b>Proces</b>      |
| <b>5</b> | <b>Rekomandimi 5</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë rishikim kritik të procesit për zbatimit të rekomandimeve të                                                                                                                                                                                                                          | <b>ZKA</b> |  | <b>30.06.2017</b>  |

|          |                                                                                                                                                                                                                                                                    |                           |  |                   |
|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|--|-------------------|
|          | dhëna nga DAB, me qëllim të rritjes së sigurisë mbi efikasitetin dhe rregullsinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin..                                                                                                                                           |                           |  |                   |
| <b>6</b> | <b>Rekomandimi 6</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë që zyra e personelit do të aplikoj të gjitha kërkesat e rregulloreve të shërbimit civil për kompletimin e dosjeve, duke përfshirë edhe vendimet mbi përvojën e punës për gjithë stafin.               | <b>ZKA</b>                |  | <b>30.06.2017</b> |
| <b>7</b> | <b>Rekomandimi 7</b><br>Kryetari i KRPP-së duhet të ndërmerr masat e duhura për të siguruar se të gjitha pasuritë e KRPP-së të raportohen në përputhje me kërkesat e dala nga rregullorja mbi menaxhimin e pasurisë, dhe të behet shpalosja e saktë e tyre në PFV. | <b>Zyrtari i pasurisë</b> |  | <b>31.12.2017</b> |

## 5. RAPORTI FINANCIAR

## Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

### - Raporti Financiar për Vitin 2017 -

**Kodi i Organizatës Buxhetore:** 230

**Informatat kontaktuese:**

**Zyrtari Kryesor Administrativ** Z.Safet Hoxha

**Zyrtari Kryesor Financiar** Z.Ismet Abdullahu

**Data:** 27.02.2018

**1) Hyrje:**(Ju lutem paraqitni në formë tekstuale një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në buxhetin e organizatës suaj. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë!)

Buxheti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, i ndare sipas Ligjit nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, është 430,053 €, dhe atë sipas kategorive ekonomike në vijim: Paga dhe mëditje 307,799€, mallra dhe shërbime 117,253 €, dhe shpenzime komunale 5,000 €. Në buxhetin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik pjesën më të madhe të buxhetit e kanë pagat dhe mëditjet me 71.57%, mallrat dhe shërbimet me 27.26 %, dhe shpenzimet komunale me 1.16% . Buxheti i rishikuar në Projektligjin për plotsim ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125, për KRPP-në është 561,208€, dhe atë sipas kategorive ekonomike në vijim: Paga dhe mëditje 307,799€, mallra dhe shërbime 187,253 €, shpenzime komunale 5,000 €, dhe investime kapitale 61,155 €.

Buxheti përfundimtar në SIMFK ndryshon nga buxheti vjetor dhe buxheti i rishikuar dhe është =509,207€ i cili duket kështu: Pagat dhe mëditjet 307,799€, Mallrat dhe shërbimet 135,253 €, shpenzimet komunale 5,000 €, dhe shpenzimet kapitale 61,155 €.

Buxheti i shpenzuar është 415,347€: Paga dhe Mëditje 247,005€, ose shprehur në %, 48.53% e buxhetit përfundimtar. Mallra dhe shërbime 104,919 € ose 20,62 % e buxhetit përfundimtar. Shpenzimet komunale 2,351 € ose 0.46 % e buxhetit përfundimtar. Shpenzimet Kapitale 61,072 € ose 11.99% e buxhetit përfundimtar.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm, del se niveli i realizimit të buxhetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017 është në masën prej 81.53 % e buxhetit përfundimtar. Alokimi i fondeve është bërë në bazë të planit të rrjedhës së parës të përgatitur nga ZKF në bashkëpunim me Bordin e KRPP-së. Në këtë raport do të paraqiten në mënyrë të hollësishme shpenzimet e realizuara nga buxheti i KRPP-së për vitin 2017, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtit vit 2016 . Bordin e KRPP-së, respektivisht ZKF, ka qenë kujdesshme dhe për asnjë moment, nuk kemi arritur në një pozitive të mungesës së fondeve në dispozicion, apo vonësës së pagesës së faturave të pranuar.



## **2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:**

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht ndryshimet kryesore për sa i përket vlerave të parashikuara dhe atyre aktuale për secilën kategori. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë)

### **a) Të hyrat:**

KRPP-ja nuk gjeneron të hyra.

### **b) Pagat dhe mëditjet:**

(Ju lutem të bashkëngjitet organogrami i organizatës suaj si aneks i këtij raporti financiar dhe plotësoni tabelën shtesë lidhur me strukturën e pagesës në pikën 4 g) të këtij raporti)

Kategoria e Pagave dhe meditjeve merr pjese ne buxhetin perfundimtar me 307,799€ ose me 60.44% ne buxhetin përfundimtar të KRPP-së . Shuma e shpenzuar ne kete kategori per vitin 2017 eshte 247,005 ose shprehur ne perqindje 80.24% e buxhetit ne kete katgori ose 59.46 % krahasuar me buxhetin e shpenzuar te KRPP-së.

### **c) Mallra dhe Shërbime:**

Kategoria e Mallrave dhe Sherbimeve merr pjese ne buxhetin perfundimtar me 135,253 € ose me 26.52% ne buxhetin përfundimtar të KRPP-së . Shkalla e shpenzimit te buxhetit ne kete kategori ekonomike per te vitin 2013 eshte 104,919 €, shprehur ne perqindje 77.77 % e buxhetit ne kete kategori ose 25.30 % krahasuar me buxhetin e shpenzuar te KRPP-së.

***d) Shpenzime komunale:***

Kategoria e shpenzimeve komunale merr pjese ne buxhetin perfundimtar me 5,000€ ose me 0.92% ne buxhetin përfundimtar të KRPP-së. Shkalla e shpenzimit te buxhetit ne kete kategori ekonomike per vitin 2017 eshte 2,351 €, shprehur ne perqindje 47.02 % e buxhetit ne kete kategori ose 0.48 % krahasuar me buxhetin e shpenzuar te KRPP-së.

***e) Investimet Kapitale:***

Kategoria e Investimeve Kapitale merr pjese ne buxhetin perfundimtar me 61,155. € ose me 11.03% ne buxhetin e KRPP-së keto fonde jane te ndara për projektin e e-prokurimit. Shkalla e shpenzimit te buxhetit ne kete kategori ekonomike per vitin 2017 është 61,072 €, ose shprehur ne pe'rqindje 99.86 % e buxhetit ne kete kategori ose 14.70% krahasuar me buxhetin e shpenzuar te KRPP-së.

***f) Subvencionet dhe Transferet:***

### 3) Përmbledhje:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht vërejtjet përfundimtare lidhur me buxhetin e institucionit tuaj apo pikëpamjet për zhvillimet në të ardhmen)

Në raport do të paraqiten në mënyrë të hollësishme shpenzimet e realizuara nga buxheti i KRPP-së për vitin 2017, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtte të vitit 2016.

Siç shihet nga tabela e mëposhtme në kategorit ekonomike të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2017 kemi shpenzime më të vogla po thuajse në të gjitha kategorit ekonomike, kjo për arsye të vonësive në përfundimin e platformës së e-prokurimit .

Raporti i krahasimit në mes të buxhetit të planifikuar me rishiqim dhe atij të shpenzuar është bërë duke e krahasuar atë me buxhetin përfundimtar.

Tek detajet e shpenzimeve për mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike në nënkategorit ekonomike kemi disa raste kur kemi të planifikuara shpenzime por nuk kemi realizim të shpenzimeve dhe në raste të tjera kemi realizim të shpenzimeve të pa planifikuara

Krahasimet në tabelën 4.b) janë në mes buxhetit të shpenzuar dhe buxhetit përfundimtar në SIMFK; kurse në tabelën 4.c) në mes buxhetit të shpenzuar dhe buxhetit planifikuar me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr.05/L-125.

---

Nënshkrimi i Udhëheqësit të Organizatës

**4) Tabelat:**

**4.a) Të hyrat:**

(Ju lutem plotësoni tabelën me informatat e nevojshme. Mund të shtohen rreshta shtesë në tabelë)

| Kodi Ekonomik | Kategoria Ekonomike | Të hyrat e planifikuara/parashikuara për vitin 2017 | Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2016 | Të hyrat realizuara në vitin 2017 |
|---------------|---------------------|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------|-----------------------------------|
| 1             | 2                   | 3                                                   | 4                                          | 5                                 |
|               |                     |                                                     |                                            |                                   |

[illegible]

**4.b) Shpenzimet:**

(Ju lutem plotësoni tabelën me të dhënat e nevojshme.)

